


QEVERISJA VENDORE NË SHQIPËRI

Raport mbi situatën aktuale

2022



INSTITUTI
PËR BASHKITË
E SHQIPËRISË



INSTITUTI PËR BASHKITË E SHQIPËRISË
'për qytete të qëndrueshme'

QEVERISJA VENDORE NË SHQIPËRI

RAPORT MBI SITUATËN AKTUALE

Tiranë, 2023

Autor:

Agron Haxhimali

Bashkëpunëtorë:

Aida Cacaj, Margarita Buxhaku dhe Blerina Xhani

Ky publikim është përgatitur nga Instituti për Bashkitë e Shqipërisë dhe me mbështetjen financiare të Fondacionit Hanns Seidel, Shqipëri. Ky botim pasqyron opinione dhe qëndrimet e Institutit të Bashkive dhe jo domosdoshmërisht të Fondacionit Hanns Seidel. Autorët garantojnë pasqyrimin me korrektësi të të dhënave të marra nga materialet e referencës të përdorura.



INSTITUTI
PËR BASHKITË
E SHQIPËRISË



FONDACIONI
HANNS SEIDEL
SHQIPËRI

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrja dhe qëllimi i raportit	7
2. Profili i Shqipërisë	9
2.1 Qeverisja vendore në Shqipëri	9
2.2 Funkcionet e bashkive dhe qarqeve	10
3. Diversiteti	12
4. Prezantimi i qeverisë vendore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar	14
4.1 Grantet e Qeverisë Qëndrore për Qeverinë Vendore	15
5. Ngjarjet kryesore që shënuan vitin 2022 për Pushtetin Vendor	16
6. Rekomandime strategjike dhe institucionale	18
7. Të drejtat dhe përgjegjësitë e Njësive të Qeverisë Vendore	19
7.1 Legjislacioni vendor gjatë 2022	20
7.2 Bashkitë dhe pronat bashkiake	23
7.3 Bashkitë dhe mbrojtja civile	25
7.4. Transparenca dhe llogaridhënia	26
8. Funkcionet e bashkive	28
8.1 Mbrojtja e mjedisit	28
8.2 Menaxhimi i mbetjeve	30
8.3 Furnizimi me ujë dhe reforma në sektorin e ujësjellës kanalizimeve	33

8.4 Rrugët rurale dhe infrastruktura	37
8.5 Mirëmbajtja dhe ndërtimi i objekteve arsimore	39
8.6 Shërbimet sociale në bashki	40
8.7 Ndërtimet post tërmetit në 11 bashkitë e prekura	46
8.8 Bujqësia dhe zhvillimi rural	49
8.9 Përfundime mbi funksionet	51
9. Performanca Buxhetore e Njësive të Qeverisjes Vendore për vitin 2022	52
9.1 Hyrje	52
9.2 Burimet financiare	54
9.3 Ecuria e të ardhurave nga burimet e veta vendore sipas NjQV	55
9.4 Shpenzimet e Njësive të Qeverisjes Vendore	60
Ecuria e shpenzimeve sipas Njësive të Qeverisjes Vendore	60
9.5 Detyrimet e Prapambetura të NjQV	61
10. Numri i Punonjësve të NjQV	65
Programi i Institutit dhe Shërbimet	66
Aneks 1: Detyrimet e Prapambetura të NjQV për periudhën 2020-2022 (në milionë lekë)	69
Aneks 2: Transferta e pakushtëzuar për bashkitë për vitin 2022	72
Referenca	76

Lista e Tabelave

Tabela 1.	Të dhëna mbi profilin e Shqipërisë	9
Tabela 2.	Ndryshimet kryesore të legjisllacionit gjatë 2022	21
Tabela 3.	Peshimi i mbetjeve në Shqipëri, 2022	31
Tabela 4.	Treguesit e performancës për FU dhe Kanalizime, 2022	36
Tabela 5.	Shërbimet sociale të ofruara në bazë qarku.	41
Tabela 6.	Ofrimi i shërbimeve sipas bashkive.	43
Tabela 7.	Ecuria e zbatimit të buxhetit të Njërive të Qeverisjes Vendore	52
Tabela 8.	Burime financiare të NjQV sipas kategorive (në lekë)	54
Tabela 9.	Të ardhurat nga burimet e veta sipas kategorive (në lekë)	56
Tabela 10.	Shpenzimet e NjQV nga burimet e veta (në lekë)	60

Lista e Grafikëve

Grafiku 1.	Transparenca e pushtetit vendor gjatë 2022	26
Grafiku 2.	Mbulimi i pastrimit në % ne rang vendi	31
Grafiku 3.	Transferta për rrugët në 2022	38
Grafiku 4.	Paraqet peshën specifike të shpenzimeve vendore sipas funksioneve në 9 mujorin 2022 kundrejt 2021	40
Grafiku 5.	Kategoria e shërbimeve sociale në nivel vendor	43
Grafiku 6.	NE sipas procesit me pikëzim dhe sipas 6%	45
Grafiku 7.	Nr. i godinave arsimore sipas statusit të tyre	47
Grafiku 8.	Fondi i ndërtimit në miliardë lekë	48
Grafiku 9.	Transferta në fushën e pyjeve dhe ujitjes dhe kullimit	50

RAPORT MBI QEVERISJEN VENDORE NË SHQIPËRI 2022

Grafiku 10. Krahasim i të ardhurave dhe shpenzimeve 2021/2022	53
Grafiku 11. Pesha e burimeve të të ardhurave kundrejt totalit	55
Grafiku 12. Të ardhurat nga burimet e veta sipas kategorive (në lekë) krahasuar me 2021	57
Grafiku 13. Taksa e ndërtesës krahasuar me 2021	58
Grafiku 14. Taksa e ndikimit në infrastrukturë krahasuar me 2021	59
Grafiku 15. Stoku i detyrimeve të prapambetura sipas zërave	62
Grafiku 16. Situata financiare e bashkive, 2022	63
Grafiku 17. Ndryshimi i nr të punonjësve	65

Pushteti vendor prek jetën e të gjithëve çdo ditë

1. Hyrja dhe qëllimi i raportit

Instituti për Bashkitë e Shqipërisë vjen me këtë raport vjetor mbi situatën e bashkive dhe zhvillimet në pushtetin vendor për vitin 2022. Ky raport është një përmbledhje e zhvillimeve më kryesore që përbëjnë panoramën e pushtetit vendor në harkun njëvjeçar.

Raporti ka për qëllim të:

- vlerësojë aspektet më përfaqësuese të aktiviteteve, funksioneve dhe performancës së pushtetit vendor në Shqipëri dhe ndërlidhjen me mjedisin politik, institucional etj;
- vlerësojë efektivitetin dhe efikasitetin e bashkive, fokusuar në përmbushjen e misionit të bashkive, shërbimet publike dhe administrative, bazuar në fakte dhe tregues nga burime institucionale;
- vlerësojë dinamikën e zhvillimeve vendore, marrëdhëniet ndërqeveritare, transparencën e bashkive;
- vlerësojë performancën e bashkive për funksionet që atyre ju ngarkon Ligji 139/2015 për 'Vetëqeverisjen Vendore';
- vlerësojë performancën financiare të bashkive;
- nxjerrë mësim dhe japë rekomandime strategjike dhe institucionale për përmirësimin e mëtejshëm të decentralizimit, reformimit dhe konsolidimit të pushtetit vendor, të vlefshme për vetë bashkitë dhe institucionet qeveritare apo komunitetin e donatorëve, si dhe

- të prezantojë një përmbledhje sa më të lexueshme për lexuesit, aktorët vendas dhe të huaj që kanë interes për të njohur dinamikën e zhvillimeve vendore në Shqipëri.

Raporti sjell në vëmendje të lexuesit, qoftë qeverisë apo institucioneve qendrore e vendore, institucioneve të huaja e çdo pale të interesuar problematikat dhe vështirësitë e pushtetit vendor në ofrimin e shërbimeve dhe organizimin e funksionimit të tyre, problematika të shfaqura nga Reforma Territoriale Administrative apo të trashëguara dhe një apel që ndërmarrja e reformave kërkon medoemos konsensus sa më të gjerë dhe një qasje sa më demokratike.

Nga ana tjetër, raporti synon të rrisë ndërgjegjshmërinë e aktorëve dhe faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm për domosdoshmërinë e mbështetjes së bashkive, por edhe për potencialin dhe mundësitë që ofrojnë bashkitë për investitorë, partnerë, bashkëpunime dhe investime në sektorë të ndryshëm të ekonomisë lokale, kryesisht në turizëm, agrobujqësi, infrastrukturë, energji të rinovueshme etj.

Çështjet, rekomandimet dhe sugjerimet e këtij raporti janë mundësi për të hapur diskutime për përmirësime dhe rishikime të mëtejshme, në kuadër të një debati dhe diskutimi politik dhe teknik në vazhdimësi për reformat në administratën publike lokale dhe decentralizim.

2. Profili i Shqipërisë

Tabela 1. Të dhëna mbi profilin e Shqipërisë Burimi: Banka Botërore

Shqipëria	2022
Popullsia, milionë	2.8
PBB, miliardë USD	17.2
PBB për frymë, USD	6,089.5
Pritshmëria e jetëgjatësisë, vjet	78.6
Numri i bashkive	61
Numri i qarqeve	12

2.1 Qeverisja vendore në Shqipëri

Qeverisja vendore në Shqipëri përbëhet nga 61 bashki që përfaqësojnë nivelin e parë të pushtetit vendor dhe 12 këshillat e qarqeve që përfaqësojnë nivelin e dytë. Bazuar në kuadrin ligjor kombëtar pushteti vendor mbart disa karakteristika themelore shumë të mira që përbëjnë dhe thelbin për demokracinë lokale.

Mënyra e formimit:

Janë organe kushtetuese (nenet 108-113, janë të pavarura nga organet e ekzekutivit qëndror).

Shtrirja tokësore:	Shtrijnë veprimtarinë e tyre në një territor të caktuar (nën një juridiksion të caktuar) Ligj 115/2014 për ndarjen administrative.
Karakter i kompetencave:	Kanë kompetenca të përgjithshme.
Struktura:	Njesia ka organ individual/ekzekutivin (kryetarin) dhe organin kolegjal/legjislativin (këshillin bashkiak).
Burimi i financimit:	Financohet nga buxheti i shtetit, të ardhurat e veta dhe burime të tjera.
Pushteti buron nga vota:	Kuadri ligjor dhe ai zgjedhor kanë përcaktuar se i vetmi që zgjidhet me votë të drejtpërdrejtë është kryetari i bashkisë.

Organizimi dhe funksionimi i qeverisjes vendore përcaktohet nga Ligji për 'Vetëqeverisjen vendore' 139/2015, si dhe Ligji për 'Financat vendore' 68/2017. Theksojmë këtu se bazë e shëndetshme për mirëfunksionimin dhe qeverisjen vendore është edhe zbatimi i Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore të Këshillit të Evropës.

2.2 Funksionet e bashkive dhe qarqeve

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksione dhe kompetenca ekskluzive si dhe funksione të deleguara. Ligji për vetëqeverisjen vendore ka parashikuar një 'menu' të mirë dhe të 'bollshme' funksionesh për bashkitë. Janë rreth 41 të tilla të shpërndara në këto fusha:

- infrastrukturë dhe shërbime publike
- shërbime sociale
- kulturë, sport dhe shërbime argëtuese
- mbrojtja e mjedisit
- bujqësi, zhvillim rural, pyje dhe kullota publike, natyrë dhe biodiversitet
- zhvillimi ekonomik vendor
- siguria publike.

Por, ndryshe nga bashkitë që përfituan nga reforma territoriale dhe administrative e vitit 2015, funksionet e qarkut mbetën ato të vitete 2000, pasi reforma e vitit 2015 nuk i përfshiu këshillat e qarqeve. Reformimi i tyre është i domosdoshëm për tju përgjigjur dinamikave aktuale, ndryshimeve apo reformave lokale, rajonale dhe kombëtare. Por, ngushtësisht funksionet e qarkut janë ndërtimi e zbatimi i politikave rajonale, harmonizimi i tyre me politikat shtetërore, në nivel qarku, si dhe çdo funksion tjetër i dhënë me ligj.

Bazuar në këto funksione, bashkitë kanë mbajtur si prioritet për vitin 2022 këto 4 kolona prioritare:

- Konsolidimi i kapaciteteve operacionale më shumë sesa ato strategjike.
- Stabiliteti dhe përshtatshmëria e sistemit të transfertave qeveritare si dhe forcimi i sistemit të menaxhimit të financave publike në nivelin vendor, dhe shlyerja e detyrimeve vendore.
- Zhvillimi ekonomik vendor që mbetet sfidë shumë e vështirë për bashkitë edhe tani 8 vite pas reformës territoriale. Orientimi bazuar mbi zhvillimin ekonomik lokal akoma nuk është kuptuar dhe akoma nuk ka marrë përparësi. Ngritja dhe përditësimi i standardeve minimale kombëtare për shërbimet vendore e kërkuar dhe e planifikuar në Strategjinë e Decentralizmit për 2023-2030 do të shërbejë ndër të tjera si shtysë për bashkitë drejt qasjeve zhvillimore dhe ekonomisë lokale.
- Sigurisht, jo jashtë vëmendjes kanë qenë përpjekjet e qeverisjes së mirë në nivelin vendor dhe çëshjet e integritimit evropian dhe qeverisë vendore.

3. Diversiteti

61 bashkitë shqiptare dallohen nga shumëllojshmëria e karakteristikave të disa aspekteve si diversiteti demografik, diversiteti ekonomik, diversiteti kulturor, diversiteti gjeografik dhe faktorëve socio-ekonomikë që ekzistojnë brenda juridiksionit të tyre. Ky diversitet mund të përfshijë edhe faktorë të tillë si moshë, gjinia, përkatësia etnike, gjuha, niveli arsimor, të ardhurat, statusi i punësimit dhe strehimit, aftësitë menaxheriale etj.

Edhe pse kemi një diversitet që është natyral dhe përbën kapital të rëndësishëm, ajo që bie në sy dhe duhet theksuar është vendosja e disa rregullave për klasifikimin e bashkive tona. Sot, nuk gjejmë ndonjë klasifikim të qartë bazuar mbi metodologjinë standarte se kush janë bashkitë urbane apo rurale. Edhe pse reforma territoriale e vitit 2015 krijoi bashki mikse nevoja për klasifikim mbetet adekuat. Çfarë do të quajmë bashki të vogël, të mesme apo të madhe? Sot njihen 12 bashki qendër qarku, ndër të cilat dhe bashkia Tiranë si bashkia e kryeqytetit por mendojmë se ka nevojë për definicione të tjera. Mungesat në informacion ose statistika të tjera përkatëse lokale, por jo vetëm, janë penguese për modelin apo tendencën në aspektin e diversitetit dhe klasifikimeve.

Pse duhet një kategorizim?

Kuptimi i diversitetit brenda bashkive është i rëndësishëm sepse mund të ketë ndikime të rëndësishme për politikën dhe programet që lidhen me fusha të tilla si arsimi, kujdesi shëndetësor, punësimi dhe shërbimet sociale. Në këtë

aspekt edhe qeveria edhe vetë bashkia duhet të orientojnë politikat. Psh, sipas të dhënave nga Instat dhe burimeve të tjera, në 3 qarqe si Gjirokastra, Dibra apo Kukësi që kanë një largim masiv të popullsisë, ky është mjaftueshëm për të riorientuar politikat në arsim apo sektorë të tjerë të ekonomisë lokale. Pra, të kuptuarit e nevojave specifike të komuniteteve të ndryshme mund t'i ndihmojë bashkitë të zhvillojnë politika që janë më gjithëpërfshirëse dhe më të përgjegjshme ndaj nevojave të të gjithë banorëve, dhe të mos mbeten në ato qasje statike.

Në fund të fundit, të kuptuarit e diversitetit në bashki kërkon një qasje më racionale dhe specifike për kontekstin, duke marrë parasysh karakteristikat dhe dinamikën unike të secilit komunitet. Por, me shumë rëndësi është edhe ndarja e mjeteve financiare nga qeveria për vendorët, përcaktimi i prioriteteve në investime urbane dhe rurale apo çështje të tjera që lidhen me energjinë dhe ekonominë gri.

Ekzistenca e këtij diversiteti bashkiak duhet të na çojë në qasjen asimterike të përgjegjësive dhe funksioneve bashkiake. Këtu, do shihen dhe ndikimet pozitive në shërbime dhe menaxhim apo përfaqësim.

4. Prezantimi i qeverisë vendore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar

Prezantimi i qeverisjes vendore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar është me rëndësi për mënyrën se si zyrtarët dhe përfaqësuesit e qeverisjes vendore komunikojnë dhe ndërveprojnë me nivelet më të larta të qeverisjes dhe vende të tjera. Kjo përfshin mënyrën se si ata përfaqësojnë interesat, politikat dhe programet e komunitetit të tyre në platformat kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në nivel kombëtar, zyrtarët e qeverisjes vendore janë përfaqësuar nga shoqatat e tyre. 61 Bashkitë (kryetari dhe këshillat bashkiakë) janë përfaqësuar historikisht nga Shoqata e Bashkive të Shqipërisë e krijuar në vitin 1993, dhe Shoqata për Autonomi Vendore e krijuar në vitin 2010. Të dyja këto organizata kanë qenë një zë i fortë në marrëdhënie me qeverinë dhe institucionet qendrore, nëpërmjet konsultimeve, opinioneve dhe qëndrimeve.

Këto organizata që nga viti 2010 kanë funksionuar mbi bazë të anëtarësimit sipas përfaqësimit politik. Një qasje aspak e mirë, por deri diku një qasje që i 'ngjante' kulturës dhe zhvillimeve të vendit. Duke filluar nga viti 2022, përfaqësimi i bashkive kaloi te Shoqata për Autonomi Vendore, pasi bordi i Shoqatës së Bashkive vendosi ta mbyllë organizatën e saj. Ndërsa, niveli i dytë i qeverisjes vendore është përfaqësuar me organizatën e saj historike - Shoqata e Këshillave të Qarqeve.

Në nivel ndërkombëtar, përfaqësimi ka pasur mjaft paqëndrueshmëri. Dhe aty ku ka funksionuar, nuk ka qënë pluralist, përfaqësues apo me të drejta të plota. Psh, në Kongresin e Autoriteve Lokale dhe Rajonale delegacioni kombëtar shqiptar ishte kompozuar pa asnjë përfaqësues nga të zgjedhurit opozitarë. Po kështu, edhe organizatat e tjera si Këshilli Evropian i Bashkive dhe Rajoneve apo Rrjeti i Shoqatave të Autoriteve Vendore në Evropën Juglindore etj, përfaqësimi nuk ka qënë i duhuri.

Viti 2022 shënoi përpjekje të madhe për të unifikuar zërin e bashkive në një organizatë të vetme pluraliste por pa rezultat. Përpjekje, qëndrime apo iniciativa u ndërmorrën edhe nga Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve të Evropës - CMRE, Swiss Development Cooperation - SDC dhe Rrjeti i Shoqatave të Autoriteve Lokale në Evropën Juglindore - NALAS.

Viti 2023 është viti i zgjedhjeve vendore. Nga këto zgjedhje pritet konfigurim dhe një mozaik pluralist në të dy nivelet e përfaqësimit të bashkisë; kryetarë dhe këshilla bashkiakë. Kjo do të jetë mundësia për të bërë bashkë në një organizatë përfaqësuesit vendorë të të gjithë spektrit. Ndarja mbi baza politike nuk është aspak e mirë. Bashkimi duhet të vijë nga gjithpërfshirja dhe gjithpërfaqësimi.

4.1 Grantet e Qeverisë Qëndrore për Qeverinë Vendore

Legjislacioni ka përcaktuar burimet e financimit të pushtetit vendor. Ato janë nga grantet qeveritare dhe të ardhurat e veta apo burime të tjera.

Për vitin 2022, grantet qeveritare kanë qënë nga: transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme (1% e GDP), transfertat e pakushtëzuar sektoriale, si dhe fonde të kushtëzuara nga programe të ministrive apo agjensive qeveritare kryesisht në investime apo grante për shlyrje të detyrimeve të bashkive (detaje në pjesën e raportimit financiar për 2022).

5. Ngjarjet kryesore që shënuan vitin 2022 për Pushtetin Vendor

Gjatë vitit 2022 zhvillimet në pushtetin vendor nuk ishin të pakta. Ka disa ndërhyrje reformuese në disa sektorë. Këto ndërhyrje erdhen si rezultat i nevojës për t'ju përgjigjur kohës dhe për ti dhënë një dimension të ri disa shërbimeve.

Kështu, në kuadrin e digjitalizimit dhe qeverisjes elektronike, zyrat e **shërbimit të gjendjes civile** nëpër bashki dhe njësi administrative pësuan reduktime, nga 350 në 150 të tilla në të gjithë Shqipërinë. Shërbimet do të përfitohen nga portali qeveritar e-Albania. Reforma e duhur, por që duhet të shoqërohej edhe me masa të tjera lehtësuese dhe të aksesueshme për kategori dhe shtresa sociale jo përdoruese të sistemeve online.

Një zhvillim tjetër lidhet me **rajonalizimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve**. Ky shërbim ishte ekskluzivitet i bashkive që në vitin 2015. Por, në të vërtetë 58 ndërmarrjet që vareshin nga 61 bashki, patën një performancë aspak të mirë në menaxhim, shërbim, apo financa. Këto ndërmarrje krijuan një borxh të madh ndaj operatorit të shpërndarjes së energjisë elektrike, detyrime ndaj Ministrisë së Financave apo debi ndaj operatorëve të ndryshëm. Këto ndërmarrje dhe në vitin 2022 nuk kuptuan dhe nuk ndërtuan modelin e tyre ekonomik, ndaj rajonalizimi ishte hapi i duhur. Ajo që hap shumë debate dhe diskutime në aspektin e decentralizimit dhe përgjegjësisë është jo ristrukturimi dhe riorganizimi i 58 ndërmarrjeve në vetëm 15 në të tërë vendin, por fakti që u vendos me ligj që 51% e aksioneve

të këtyre ndërmarrjeve të reja të jenë në kontrollin e qeverisë qendrore. Pra, kjo do të çojë në një rol më të dobësuar të pushtetit vendor.

Strategjia e decentralizimit. Gjatë vitit 2022 u punua për strategjinë e re të decentralizimit pasi strategjia e mëparshme kishte përfunduar që në vitin 2020, por ndërkohë ishte vepruar me një plan veprimi 2 vjeçar. Bërja e kësaj strategjie 6 muaj përpara zgjedhjeve vendore ishte një nxitim i panevojshëm. Kjo, për arsye se procesi konsultues është brenda të njëjtës palë po ashtu dhe formacioni politik (qeveri-bashki). Një dokument i tillë ka nevojë për mendime nga i gjithë spektri politik dhe për konsensus, pasi është një dokument afatgjatë në qëllime dhe veprime. Do ishte veprim i mirë nëse kalohet në një fazë rishikimi të këtij dokumenti me të zgjedhurit e rinj vendorë në vitin 2023.

Komisioni bipartizan për **rishikimin e reformës territoriale dhe administrative të vitit 2015**, ishte një nga ngjarjet më të rëndësishme politike dhe që tërhoqi vëmendje dhe interes të madh gjatë vitit 2022. Komisioni parlamentar punoi për 6 muaj me ekspertë e grupe interesi dhe bëri një punë të mirë proceduriale. Komisioni doli me dy raporte nga ekspertët e pozitës dhe opozitës. Kjo nuk shënoi lajm të mirë politik dhe institucional dhe nuk prodhoi çfarë pritej.

Në programet mbështetëse të pushtetit vendor, për të shënuar dhe theksuar si ngjarje, është asistenca e Organizatës së Sigurimit dhe Bashkëpunimit Evropian, zyra Tiranë, për përgatitjen e metodologjisë së Kapitalit Natyror në nivel vendor, dhe aplikimin e saj në bashkitë Mat, Pogradec, Roskovec dhe Selenicë. Kjo realizohet për herë të parë në Shqipëri por edhe në rajon.

6. Rekomandime strategjike dhe institucionale

Pushteti vendor mbetet ende në nevojë për mbështje për rritje kapacitetesh, menaxhim dhe burime financiare.

Bashkitë janë të nënfinancuara në raporte me përgjegjësitë, funksionet dhe nevojat reale që ato kanë.

Dyfishimi i transfertës nga 1% e PBB-së në 2% do të shënonte një dinamizëm të ri për sasinë dhe cilësinë e shërbimeve bashkiake.

Decentralizimi, jo si qëllim në vetvete por as si stacion fundor.

Modeli i qeverisjes vendore në Shqipëri dhe konteksti aktual kërkojnë të kalohet nga decentralizim simetrik në atë asimetrik.

Bashkitë duhet të mendojnë dhe gjejnë zgjidhje lokale për problemet lokale. Bashkiakët nuk duhet vetëm të parashtrojnë problemeve por duhet të artikulojnë zgjidhje konkrete.

Bashkitë duhet që të inkurajojnë eksperimentimin pozitiv brenda institucionit: Provo, Mëso, Përsërit, Përshtat, siguro Autonominë.

Bashkitë kanë nevojë për një menaxhimin të integruar dhe të rregullt që lejon përshtatjen në kohë reale dhe kontekstin real dhe për baza të shëndetshme të zhvillimit ekonomik lokal.

Bashkitë duhet të jenë më të hapura ndaj partnerëve, aktorëve, donatorëve dhe shoqërisë civile për të siguruar që reformat lokale të jenë të zbatueshme dhe të besueshme.

7. Të drejtat dhe përgjegjësitë e Njësive të Qeverisë Vendore

Viti 2022 nuk ka shënuar ndryshime domethënëse në kuadrin rregullator apo në performancën e njësive të qeverisjes vendore. Përsa i përket organizimit dhe strukturimit të tyre, situata është shumë e ngjashme me vitet paraardhëse dhe karakterizohet nga organizimi në bashkinë qendër dhe struktura jo shumë të unifikuara në njësitë administrative përbërëse.

Tentativa për një reformë territoriale ndërmarrë gjatë 2022 u nis me synimin për të ndryshuar peisazhin e organizimit territorial të bashkive. Ngritja e shqetësimeve nga aktorë të ndryshëm lokalë dhe kombëtarë arriti në nivelin e Kuvendit me Komisionin e Posaçëm e megjithë diskutimet dhe argumentat teknike në mbështetje të ndryshimeve territoriale, reforma nuk u finalizua për pasojë të ndërhyrjeve të pastra politike.

Ndërkohë që bashkitë janë rezistente ndaj ndryshimeve në organikën e tyre, legjislacioni vazhdon të ngarkojë njësitë vendore me detyra dhe përgjegjësi të pabuxhetuara. Përmendim këtu grupet vendore të veprimit, që sipas Ligjit 36/2022 do të duhet të funksionjnë në mbikqyrjen e bashkive. Roli i këtyre grupeve është teorikisht mjaft i rëndësishëm, sipas modelit LEADER që është ndjekur, duke hartuar dhe zbatuar strategjitë lokale të zhvillimit. Por, kur bëhet fjalë për financimin e këtyre strategjive ligji parashikon si burime kryesore fonde të bashkisë, kuota anëtarësimi dhe fondet IPARD. Me gjasë këto të fundit do të jenë dhe shtylla kryesore rreth së cilës do të fokusohet puna e këtyre grupeve.

Këshillat bashkiakë ende karakterizohen nga përbërja homogjene politike në të 61 bashkitë e vendit. Vazhdon klima e mbështetjes së kryetarit, e cila bazohet në përkatësinë politike dhe jo në bindjen teknike për dobinë e vendimeve të miratuara.

Çështje të tjera bashkiake që kanë mbizotëruar vitin 2022 lidheshin me impiantet për trajtimin e mbetjeve në bashkitë Tiranë, Elbasan dhe Fier, rajonalizimin e shërbimeve të furnizimit më ujë, trajtimin të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, apo me situatën e borxhit vendor dhe me menaxhimin e fatkeqësive natyrore.

7.1 Legjislacioni vendor gjatë 2022

Përgjatë vitit 2022 nuk janë shënuar iniciativa ligjvënëse që do të sillnin ndikim thelbësor në njësitë e qeverisjes vendore, kjo mund të jetë tregues stabiliteti ose caktimi i prioriteteve të tjera në rang kombëtar.

Gjatë vitit 2022 ka nisur puna për hartimin e Strategjisë Ndërsektoriale Për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2023-2030 e cila pritet të miratohet së shpejti. Në fund të vitit 2022, pati disa iniciativa për diskutimin mbi Ligjin për Strehimin Social dhe të tjera, iniciativa që pritet të finalizohen përgjatë 2023.

Legjislacioni i mëposhtëm është nxjerrë nga Qendra e Publikimeve Zyrtare dhe i përket 177 fletoreve zyrtare të publikuara nga 1 janar deri më 31 dhjetor 2022. Aktet ligjore janë paraqitur përmbledhurazi së bashku me komentimin e Institutit për Bashkitë.

Tabela 1. Ndryshimet kryesore të legjislacionit gjatë 2022

Ligji 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”	
<p>Ligji e reformat Policinë Bashkiake si organ ekzekutiv në nivel vendor. Ai kontribon në ndarjen më të qartë të kompetencave, si dhe nivelin e ndërveprimit dhe strukturat e tjera ligjzbatuese dhe pse jo përfundimisht.</p> <p>Këto ndryshime do ti vlejnjë unifikimit të shërbimeve të ofruara në bashki të ndryshme.</p> <p>Ligji i miratuar saktëson procedurën të pranimit në strukturat e policisë bashkiake.</p>	<p><i>Mund të ishte më i plotë nëse do të vendosej një kriter i numrit të punonjësve të policisë bazuar në popullsinë e bashkisë. Ky kriter do duhej të ishte në çdo rast minimal duke lënë hapësira për rritjen e numrit të punonjësve sipas nevojave specifike.</i></p> <p><i>Përsa i përket kompetencave, vërejmë se ato janë zgjeruar duke shtuar në fushën e qarkullimit rrugor dhe të mjedisit. Megjithatë, kompetencat sipas ligjit të ri ngjajnë më shumë si interpretimi i zgjeruar i kompetencave të mëparshme sesa kompetenca të reja shtuar rishtas.</i></p>
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 91, datë 9.2.2022 “Për miratimin e Planit Kombëtar Për Integrimin Evropian 2022– 2024”	
<p>Plani është instrument i planifikimit dhe monitorimit të detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe i procesit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Plani 2022 – 2024 synon prioritetizimin, planifikimin, monitorimin dhe vlerësimin e përafrimit të plotë të legjislacionit shqiptar me acquis e Bashkimit Evropian si një nga kriteret e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.</p>	<p><i>Pushteti vendor është pjesë integrale e Planit të Integritimit dhe pse vëmendja kryesore mbetet tek organet e qeverisjes qendrore.</i></p>

Vendim Nr. 539, datë 30.12.2021 Për Miratimin e Metodologjisë dhe Proçedurës për Miratimin e Tarifave të Shërbimeve Ujësjiellës-Kanalizime	
<p>Metodologjia e re bazohet tek metoda e mëparshme e përdorur dhe e rivlerësuar “kosto plus”, si dhe metoda e “çmimit tavan”. Metoda “çmimi tavan” do të zbatohet për shoqëritë UK që kanë objektiv mbulimin 100% të kostove totale me të ardhurat e aktivitetit. Metoda “kosto plus” do të zbatohet për shoqëritë UK që aplikojnë për tarifa të reja dhe mbulojnë deri në 100% kostot e pranuar operacionale gjatë periudhës rregullatore të aprovuar nga KKRR-ja.</p>	<p><i>Ndryshimi i tarifave të shërbimeve të ujësjiellës kanalizimeve pritet të përmirësojë situatën e vështirë financiare të Ujësjiellësve.</i></p>
Vendim Nr. 302, datë 11.5.2022 Për Politikat Kombëtare për Riorganizimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të largimit, trajtimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura	
<p>Për kryerjen e funksioneve në dobi të përbashkët dhe përmirësimin e cilësisë të shërbimeve të ofruara në sektorin e furnizimit me ujë, si dhe largimit, trajtimit e përpunimit të ujërave të ndotura, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet tyre dhe me ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë për riorganizimin e shoqërive aksionare ekzistuese të ujësjiellës-kanalizimeve. Kur njësitë e vetëqeverisjes vendore vendosin për të krijuar shoqërinë</p>	<p><i>Ky vendim ka për synim rajonalizimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Mendojmë se efektet do të prekin fillimisht ato sh.a. të cilat nuk kanë një performancë të mirë të ofrimit të shërbimi apo financiare.</i></p>

<p>aksionare me aksionar edhe ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë, ministria zotëron jo më pak se 51 (pesëdhjetë e një) % të aksioneve me të drejta vote.</p>	
<p>Ligj Nr. 36/2022 Për Organizimin dhe Funksonimin e Grupeve Vendore të Veprimit</p>	
<p>Ky ligj përcakton parimet bazë, kriteret, përgjegjësitë dhe proceset për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit, hartimin dhe zbatimin e strategjive të zhvillimit të udhëhequra nga komuniteti, në harmoni me politikën e zhvillimit bujqësor dhe rural, në nivel qendror e vendor.</p>	<p><i>Ligji bazohet tek metodologjia LEADER dhe targeton fondet IPARD, por jo vetëm. Mendojmë se duhet të kishte me të përmështetje financiare dhe të burimeve njerëzore nga qeveria qendrore.</i></p>

7.2 Bashkitë dhe pronat bashkiake

Bashkitë kanë të drejtën e pronës dhe shfrytëzimit të pronave të tyre për krijimin e të ardhurave. Deri më sot, shfrytëzimi i pronave bashkiake është i nënvlerësuar duke mos sjellë të ardhura për bashkitë në potencialin që pronat kanë.

Gjatë këtij viti u shënuar dhe një ndërhyrje e qeverisë qendrore në përjashtimin e subjekteve nga taksat vendore. Rasti lidhet me investitorin që do të zhvillojë projektin e “Durrës Yachts & Marina”, i cili është përjashtuar nga pagesa e taksës së infrastrukturës dhe ajo e strehimit social. Ky përjashtim është bërë me vendim¹ të Komitetit të Investimeve Strategjike, ku është bërë kalimi i masave mbështetëse të kompania e përbashkët, që do të krijohet nga investitori dhe shteti shqiptar. Taksa e ndikimit në infrastrukturë llogaritet për Durrësin në 4 për qind (të vlerës së shitjes së një m²) ndërkohë që fondi që kalon për strehimin social është 3 për qind e sipërfaqes së ndërtimit.

¹ <https://www.aida.gov.al/images/PDF/Vendimet-e-komitetit/VKIS%20MARINA%20DHE%20JAHTET%20E%20DURRESIT%20PER%20JV.pdf>

Vlera që nuk do të paguhet në taksa do të jetë pjesa e kontributit të shtetit shqiptar në investim.

Një çështje tjetër shqetësuese është regjistrimi i pronave shtetërore në përgjithësi. Bashkitë paraqesin si vështirësi mungesën e fondeve për regjistrimin e pronave dhe kërkojnë nga zyrat e regjistrimit të pasurive procedura më të thjeshtuara për institucionet publike, ose një sportel të dedikuar.

Sipas Agjencisë Shtetërore të Kadastrës², në vitin 2020 ishin evidentuar rreth 230.000 prona shtetërore. Sot, ky numër ka shkuar në rreth 260.000 prona shtetërore të identifikuara, nga këto 115.000 prona, ju janë transferuar institucioneve qendrore dhe vendore dhe 20.000 pasuri, rezultojnë të regjistruara në Kadastër.

Gjatë vitit 2022, u hartua Vendimi Nr. 28³ “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”. Ky vendim ka për qëllim: a) përcaktimin e procedurave të përditësimit të plotë apo të pjesshëm të pronave të paluajtshme shtetërore, të inventarizuara ose jo, në pronësi ose përdorim apo përgjegjësi administrimi të institucioneve qendrore dhe njërive të vetëqeverisjes vendore; b) përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të veprimtarisë midis institucioneve shtetërore apo njërive të vetëqeverisjes vendore dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, gjatë procesit të përditësimit.

Sipas këtij vendimi, njësitë e vetëqeverisjes vendore krijojnë strukturat e posaçme të bashkëpunimit me drejtorinë përkatëse të ASHK-së, të cilat rakordojnë ndërmjet tyre, me qëllim realizimin e procedurave të parashikuara nga Ligji nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”. Të gjitha pronat e miratuara, të përditësuara në favor të njërive të vetëqeverisjes vendore, do të regjistrohen në regjistrin e

2 <https://ata.gov.al/2023/01/23/lame-regjister-per-pronat-publike/>

3 <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/01/27/28/9848ca9e-e4a7-4977-94fd-ce1e83ac6941;q=P%C3%ABr%20p%C3%ABrdit%C3%ABsimin%20e%20Pronave%20Publike>

pasurive të paluajtshme, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave për miratimin e listës së pronave shtetërore.

7.3 Bashkitë dhe mbrojtja civile

Mbrojtja civile vazhdon të mbetet një sektor në nevojë për pushtetin vendor. Pavarësisht progresit shënuar me hartimin e legjislacionit, situata lokale ka pasur përmirësime sporadike. Sipas një raporti të Bankës Botërore⁴, stafet e bashkive kanë mangësi në kuptimin e koncepteve të reja. Jo të gjitha bashkitë kanë plotësuar drejtoritë/sectorët me staf të plotë. Mënyra e mbajtjes së të dhënave në nivel vendor ndryshon nga bashkia në bashki dhe nuk është e unifikuar. Shumica e bashkive i mbajnë të dhënat në nivel raporte vlerësimi pas ndodhjes së fatkeqësive (elektronike ose të printuara), dhe disa bashki mbajnë në mënyrë elektronike të dhënat e këtyre raporteve. Ka mangësi në të dhënat që mbahen nga bashkitë përse i përket vlerësimit të humbjeve dhe dëmeve. Ka paqartësi në mënyrën e raportimit të bashkive brenda institucionit dhe në nivelet e tjera të qeverisjes.

Sfidat të tjera me të cilat përballen ende strukturat vendore në kuadër të funksionit të mbrojtjes civile kanë të bëjnë me konsolidimin e mëtejshëm dhe zbatimin sa më të mirë të kuadrit ligjor e nënligjor, ngritjen në nivel vendor të bazave të të dhënave për mbrojtjen civile; hartimin e vlerësimit vendor të rrishtit, hartimin e strategjive vendore për reduktimin e rrezikut të fatkeqësive, si dhe të planeve vendore të emergjencave civile; forcimin e strukturave vendore me rritje të numrit të punonjësve; ngritjen e kapaciteteve teknike dhe profesionale, si dhe mbështetje me investime për zhvillimin, modernizimin e aseteve si dhe rehabilitimin e infrastrukturës së emergjencës civile.


4 <https://documents1.worldbank.org/curated/en/099430106142216471/pdf/P172145046dbf40a5093060a6deca58f620.pdf>

7.4. Transparenca dhe llogaridhënia

Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin e transparencës dhe të miratojë programin e transparencës, duke siguruar akses nga të gjithë, veçanërisht nga shtresat më të varfra të komunitetit, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për të drejtën e informimit. Po të njëjtat dispozita parashikohen dhe për konsultimin publik në nivel vendor.

Bashkitë kanë shënuar progres, veçanërisht në publikimin e informacioneve online, informacione kryesisht standarte si funksionimi i bashkisë, këshilli bashkiak, struktura, buxheti vjetor apo plane vendore të miratuara etj. Këto lloj informacionesh i shërbejnë qytetarit kryesisht në mënyrë pasive, ai merr dijeni pa pasur ndonjë reagim ndaj tyre që do të sillte ndërveprim me bashkinë.

Sipas Raportit Vjetor 2022 të Komisionerit për të drejtën e informimit bashkitë ndoshen në situatën sipas grafikut më poshtë përsa i përket pasjes së programit të transparencës, caktimit të një kordinatori për informimin dhe publikimin e një regjistri të kërkesave dhe përgjigjeve.



Grafiku 1. Transparenca e pushtetit vendor gjatë 2022

Nga monitorimi i faqes zyrtare të Komisionerit⁵ për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale vihet re se për vitin 2022 janë marrë 5 vendime ndaj bashkive për mosrespektim të të drejtës për informim të publikut. Këto 5 vendime janë dhënë për 4 bashki të ndryshme, ndërsa për vitin 2021 numri i vendimeve ndaj bashkive ka qenë 11.

Në lidhje me “Publikimin e regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve”, monitorimi⁶ evidenton me pikë pozitive vetëm ato raste kur regjistri është përditësuar për kërkesat e paraqitura gjatë vitit 2022. Numri total i njësive të vetëqeverisjes vendore, të cilët kanë përditësuar regjistrin e kërkesave është 57, përkundrejt 61 bashkive të monitoruara. Megjithatë, vetëm 29 prej njësive të vetëqeverisjes vendore e kanë mbajtur regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve të rishikuar sipas modelit të miratuar nga Zyra e Komisionerit, duke pasqyruar në të përveç objektit të kërkesës dhe përgjigjen e dhënë nga autoriteti, ndërsa 28 prej tyre nuk kanë reflektuar përgjigjen e dhënë, kërkesës. Përsa i takon detyrimit lidhur me publikimin e informacionit proaktiv, i cili ka të bëjë me “Publikimi e Planit Buxhetor Afatmesëm 2022 - 2024”, është konstatuar se e kanë publikuar 39 autoritete publike, përkundrejt 61 të monitoruara (67%).

5 <https://www.idp.al/vendime-2022-ddi/>

6 [Indeksi -i-transparences -bashkite monitorim bashkite dhjetor 2022 me-kopertine-perfundimtar.pdf \(idp.al\)](#)

8. FunkSIONET E bashkive

8.1 Mbrojtja e mjedisit

Funksioni i mbrojtjes së mjedisit është një nga funksionet që neglizhohet tërësisht nga bashkitë. Ky funksion kryesisht lidhet me ndërgjegjësim mjedisor, edukimin dhe informimin mjedisor, dhe mbrojtjen e natyrës, por vetëm një numër i kufizuar bashkish arrijnë të planifikojnë personel në këtë zë buxhetor. Përgjegjësitë e NjQV në fushën e mbrojtjes së mjedisit lidhen më sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja, sigurimin e masave për mbrojtjen nga ndotja akustike, dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese mbi mbrojtjen e mjedisit.

Referuar Raportit të Monitorimit të Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve, treguesi 39, që i referohet numrit të personelit administrativ të punësuar me kohë të plotë për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në gjithë vendin vërehet se ky objektivi **nuk ka progres** dhe nuk ka një shtim të këtij numri për 2022.⁷ Për më tepër, menaxhimi i mbetjeve urbane është temë specifike e kurrikulës së ASPA por nuk ka asnjë të dhënë për realizim trajnimesh për 2022, çka dëshmon se dhe në këtë tregues nuk ka asnjë progres.

Sipas raportit 9 mujor të Ministrisë së Financave, lidhur me shpenzimet funksionale të pushtetit vendor dhe sipas peshës për funksion ndaj totalit të shpenzimeve krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë,

7 Raporti i Monitorimit të Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Mbetjeve, fq.27

konstatohet një rritje të peshës së shpenzimeve për funksionet e “Mbrojtjes së Mjedisit” me **rreth 1.1 miliard lekë**. Specifikisht, bashkia Tiranë gjatë 9 mujorit të vitit 2022 ka financuar rreth 40% të totalit të shpenzimeve,⁸ të funksionit të Mbrojtjes së Mjedisit.

Por, nga një analizë lidhur me kapacitetet njerëzore në bashkitë shqiptare vihet re se:

- 12/61 bashki kanë drejtori të posaçme për mjedisin.
- 15/61 bashki kanë sektorë të posaçëm për mjedisin;
- dhe 5/61 bashki kanë inspektorat për mjedisin.
- 29/61 bashki e kanë mjedisin në drejtori me sektorë të tjerë si pyjet, bujqësinë, mbrojtje civile dhe mbetjet, etj.

Kjo situatë tregon qartë rëndësinë dhe prioritetin e ulët që ka në tërësi mjedisi në nivel vendor. Nga 41 funksione direkte që janë transferuar në pushtetin vendor 30% e tyre janë të lidhur ngushtësisht me mjedisin, natyrën, pyjet dhe zbatimin e ligjit.

Të gjitha këto shërbime vazhdojnë të jenë të pafinancuara, dhe të pambuluara me burime njerëzore edhe pse Bashkimi Evropian thekson në raport progresin e vet për 2022 se: “Buxheti i shtetit për mjedisin dhe ndryshimin e klimës mbetet shumë i kufizuar në 2022 dhe jo i mjaftueshëm për të zbatuar *acquis* të BE. Qarkullimi i shpeshtë i stafit dhe punësimi i stafit pa ekspertizën e nevojshme ka gërryer edhe më shumë kapacitetin e administratës qendrore në këtë fushë”.⁹

Në këndvështrimin e Institutit të Bashkive të Shqipërisë, këto funksione nuk mund të vazhdojnë të jenë po njësoj të pafinancuara edhe 8 vjet pas reformës territoriale. Qeveria duhet të vendosë detyrimin e buxhetimit dhe zbatimit të mjedisit në Sistemin e Planifikimit të Integruar dhe bashkitë të buxhetojnë burime njerëzore, investime dhe aktivitete për këto shërbime.

8 Raporti 9 mujor të Ministrisë së Financave

9 Raport Progresi i BE për 2022, fq.111

8.2 Menaxhimi i mbetjeve

Sipas raportit të dytë monitorues të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, në nivel vendi trajtohen dhe përpunohen 70% e sasisë së prodhuar të mbetjeve.¹⁰ Bashkitë i bazojnë të dhënat e tyre të mbetjeve vetëm në numrin e popullsisë të shumëzuar me një koeficient mbetjesh e prodhuar për frymë e cila ndryshon midis bashkive të mëdha dhe të vogla si dhe urbane kundrejt bashkive në zonë rurale. Në vendgrumbullime, mungesa e peshoreve në venddepozitime krijon sfida të rëndësishme për mbledhjen e të dhënave dhe aftësinë për të ofruar një shërbim efektiv për menaxhimin e mbetjeve. Përveç kësaj, kur të dhënat e mbetjeve mblidhen nëpërmjet ‘metodës së parashikimit’ verifikimi i të dhënave të tilla është i vështirë. Rasti i Strategjisë Kombëtare për menaxhimin e Integruar të Mbetjeve i mbështetur nga GIZ/DKTI është një shembull klasik në këtë drejtim.

Situata aktuale në Shqipëri me raportimin e të dhënave parashikon një vetëdeklarim nga bashkitë direkt pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) (bazuar në VKM nr. 687/2015 ndryshuar me VKM nr. 538/2021). AKM ka një bazë të konsoliduar të të dhënave për menaxhimin e mbetjeve të mbledhura nga bashkitë si dhe nga industritë që kanë ndikim në mjedis. AKM ka detyrimin të verifikojë të dhënat e deklaruara/raportuara nga bashkitë dhe më pas ngarkohet në Regjistrin e Çlirimit dhe Transferimit të Ndotësve dhe përgatit raportin vjetor dhe më tej e ndajnë me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit si dhe me institucione të tjera qendrore, njësitë e qeverisjes vendore dhe Instituti Kombëtar i Statistikave.


Gjatë 2022, 18 nga 61 bashki dorëzojnë mbetjet në landfilllet sanitare ose në inceneratorë, gjë e cila siguron peshimin në hyrje të landfillit dhe kjo përbën 30% të bashkive. Ndërsa pjesa tjetër 70% e bazojnë raportimin e sasisë së mbetjeve tek peshimi i realizuar me asistencën e GIZ.

¹⁰ Qirjo.M., Shaplo.O., Raporti i monitorimit të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane 2020-2021. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Tiranë 2021

Tabela 3. Peshimi i mbetjeve në Shqipëri, 2022

Bashkia/viti	2020	2021	2022
Nr. i bashkive që peshojnë mbetjet në landfill ose inceneratorë	18	18	18
Nr. i bashkive që peshojnë mbetjet në vend depozitimin nga AKM	7	27	16
Nr. i bashkive që nuk peshojnë mbetjet në venddepozitim final	43	16	0

Sasia e grumbulluar e mbetjeve vlerësohet në rreth 705.304 mijë ton mbetje të ngurta. Raportohet se në impiantet rajonale të depozitimit përfundimtar të mbetjeve janë depozituar rreth 573 mijë ton (ose 65% e mbetjeve të grumbulluara në të gjithë vendin). Sasia e mbetjeve që depozitohen në impiante sanitare të cilat ofrojnë kushte të kontrolluara të grumbullimit të mbetjeve është rritur me rreth 40% brenda një viti. Megjithatë, në 2022 ka pasur tentativa për krijimin e një sistemi të besueshëm të peshimit të mbetjeve urbane që është realizuar në 61 bashki në total. Mesatarja e mbulimit të popullsisë në nivel vendi për vitin 2022 është 78% si tregohet në Grafikon 2 më poshtë.



Grafiku 2. Mbulimi i pastrimit në % në rang vendi.

Rikuperimi dhe riciklimi mbeten në nivele shumë të ulëta me 1-3%, ku sasinë më të madhe e zënë mbetjet plastike me 8%. Prej 199 vend depozitimeve të identifikuar në vitin 2018, gjatë 2022 janë kryer punime rehabilituese duke pasur një ecuri të ngadaltë drejt përmbushjes së objektivit për sistemimin, rehabilitimin dhe mbylljen e plotë të tyre deri në vitin 2025. Gjatë vitit 2022, janë raportuar sistemimi i një numri të kufizuar të vend depozitimeve nga programi i GIZ. Niveli i financimit të sektorit të menaxhimit të integruar të mbetjeve ka kapur shifrën e mbi 7 miliardë Lekë, duke përfshirë financimin nga buxheti i shtetit (Qeverisja Qendrore), buxhetet në nivelin vendor (Qeverisja Vendore) dhe ndihma e huaj.

Gjatë 2022 ka pasur sërish rritje të financimit prej buxhetit në nivelin vendor krahasuar me 2021, por në pak raste referohet përmirësim i cilësisë së shërbimit apo zgjerim i **mbulimit vetëm më 2% krahasuar me 2021**. Ndërkohë bashkitë referojnë se arrijnë të grumbullojnë tarifën e pastrimit në masën 60%.¹¹

Progres Raporti i Delegacionit të Bashkimit Evropian për 2022, thekson se kuadri ligjor për menaxhimin e mbetjeve është pjesërisht i harmonizuar. Mbyllja e shumë vend depozitimeve të papërshtatshme mbetet akoma një sfidë dhe vetëm një numër i kufizuar janë mbyllur gjatë kohës së raportimit. Mbledhja e ndarë e mbetjeve shtëpiake dhe instrumenteve ekonomike për të nxitur riciklimin dhe ripërdorimin dhe për të parandaluar gjenerimin e mbetjeve mbeten në nivele pilotimi dhe të kufizuara.

Viti 2022, ka shënuar një regres në aspektin e projekteve strategjike të djegësve termikë, ku ai i Elbasanit nuk është funksional dhe mbetjet e këtij qarku i janë rikthyer hedhjeve në lumë, siç raporton dhe media investigative.¹² Përpos djegësit në Elbasan dhe ai i Fierit dhe i Tiranës paraqesin shqetësime në rritje për sa i përket jo vetëm përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së për mbetjet duke përfshirë parimin e hierarkisë së mbetjeve dhe objektivat e riciklimit por dhe një sfidë të madhe financiare për bashkitë të cilat duhet të

11 Po aty

12 Inceneratori nuk punon, por mbetjet në Elbasan po digjen (zeriamerikes.com)

parashikojnë koston e djegësit termik që ndryshon mes 25\$ në Elbasan, 29\$ në Tiranë, apo 26\$ në Fier.¹³

Për shumë bashki, viti 2022 ka qenë tepër sfidues lidhur me menaxhimin e mbetjeve urbane. Gjatë 2022, qeveria prezantoi një grant prej 500 milion lekësh për të ndihmuar 21 bashki në vështirësi financiare për pagesat e koston së depozitimit të mbetjeve në incenerator ose landfill sanitar duke u munduar të mos përsëritet situata e 2021. Bashkitë përfituese janë: Belsh, Cërrik, Durrës, Elbasan, Fushë-Arrëz, Gramsh, Kamëz, Kavajë, Krujë, Kurbin, lezhë, Librazhd, Malësi e Madhe, Peqin, Përrenjas, Pukë, Rrogozhinë, Shijak, Shkodër, Vau i Dejës, Vorë. Shpërndarja e fondeve është bërë në funksion të volumit të mbetjeve dhe distancës ku bashkia Durrës ka përfituar 200 milionë nga 500 në total për 21 bashki.¹⁴

Nga ana tjetër është me interes gjetjet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ku bashkia Durrës nuk kryen ushtrimin e monitorimit dhe peshimit të saktë të mbetjeve që dërgon në landfillin e Sharrës.¹⁵

Konkretisht raporti ka nënvizuar se “nga auditimi i zbatimit të mbikëqyrjes së kontratës me objekt “Depozitimi i mbetjeve urbane bashkia Durrës”, me fond limit 1,148,864,000 lekë pa TVSh, për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2021, rezulton se nga bashkia Durrës nuk kryhet matja e sasisë së mbetjeve që do të depozitohen në landfillin e Sharrës përpara se ato të nisen me mjetet e saj për në landfill”.

8.3 Furnizimi me ujë dhe reforma në sektorin e ujësjellës kanalizimeve

Viti 2022 konsiderohet si viti i fillimit të një reforme rrënjësore në sektorin e ujit në Shqipëri e cila e agregon sektorin në 15 shoqëri UK rajonale, nga një

13 Shënim: Bashkia Durrës prodhon 43,545 ton në vit dhe vetëm tarifa e landfillit është 1.2 MEUR, pa përfshirë kosto transporti dhe kosto të pastrimit dhe grumbullimit.

14 Incenerimi i mbetjeve “gllabëron” buxhetet e bashkive, rrisin tarifatat me 50% - Qendra Fol

15 Kontrolli i Lartë i Shtetit

sektor më parë i fragmentarizuar në 58 shoqëri UK që ofrojnë shërbimin e FU dhe KUN në 61 bashki të vendit. Objektivi kryesor i këtij procesi është që nëpërmjet ekonomisë së shkallës të përmirësojë cilësinë e shërbimit, të rrisë efikasitetin dhe të përmirësojë qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve UK. Në maj 2022, nga Këshilli i Ministrave u miratua vendimi nr. 302, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.¹⁶

16 Riorganizimi i shoqërive UK si Subjekt i Kompetencave të Përbashkëta (SKP-UK) do të kryhet nëpërmjet krijimit të shoqërive të reja aksionare me dy nivele administrimi në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Njësitë e qeverisjes vendore që bien dakord për themelimin e SKP-UK-së së re do të ndjekin statutin e modelit standard që shërbejnë si akte themelore për themelimin e SKP-UK-së. SKPUK do të kryejë veprimtarinë e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në zonat e shërbimit sipas hartës territoriale, të miratuar nga AKUM. SKP-UK-ja e themeluar do të ketë në asambleen e aksionarëve përfaqësues të qeverisë qendrore MIE, e cila do të mbajë të paktën 51% të aksioneve. Pjesa e mbetur prej 49% do llogaritet në raport me numrin e klientëve aktivë që kanë shoqëritë ekzistuese në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes për themelimin e shoqërisë rajonale UK. SKP-UK-të e krijuara janë të detyruara të respektojnë marrëveshjet, detyrimet kontraktuale, kontratat e shërbimeve, si dhe çdo të drejtë që rrjedhin prej tyre, të nënshkruara ndërmjet Këshillit të Ministrave, ministrive dhe institucioneve qendrore, ndërmarrjeve të ujësjellësit dhe ish-njësite të qeverisjes vendore, me institucionet financiare ndërkombëtare dhe kompanitë kontraktuese. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në përputhje me dokumentet strategjike sektoriale të miratuara, do të ndajë të gjitha fondet e planifikuara për investime nga buxheti i shtetit apo institucionet financiare ndërkombëtare vetëm përmes SKP-UK-së së re. Bashkitë që bien dakord të marrin pjesë në procesin e riorganizimit, duhet të miratojnë dhe të ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm të kërkuar nga ligjet në fuqi për të vazhduar me transferimin e aktivitetit aktual të ndërmarrjes së ujësjellësit tek SKP-UK dhe do të procedojnë sipas dispozitave të ligjit nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në përputhje me riorganizimin dhe planin kombëtar të hartuar nga AKUM. SKP-UK i ri i krijuar nga riorganizimi në përputhje me hartën e ndarjes territoriale të hartuar nga AKUM, brenda tre muajve nga miratimi i Prefektit të Qarkut, do të aplikojë për marrjen e licencës së re për ofrimin e shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve nga Enti Rregullator i Ujit (ERRU).

Proçesi i riorganizimit sipas VKM nr.302, datë 11.05.2022 për agregimin e sektorit është ndjekur nga AKUM si institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin e këtij proçesi. Kjo konstatohet edhe nga fakti se deri në mbyllje të vitit 2022 janë arritur marrëveshjet e transferimit të aktivitetit të shërbimeve UK ndërmjet 50 bashkive dhe si rrjedhojë janë krijuar 12 shoqëri UK Rajonale nga 15 të parashikuara sipas reformës. Shoqëritë e reja Rajonale të krijuara janë **UK Korçë, UK Pogradec, UK Durrës, UK Lezhë, UK Dibër, UK Kukës, UK Berat, UK Elbasan, UK Gjirokastër, UK Fier, UK Lushnjë** dhe **UK Sarandë**. Deri në mbyllje të vitit 2022 vetëm 2 shoqëri UK Rajonale përkatësisht UK Korçë dhe UK Pogradec e kanë filluar ushtrimin e aktivitetit me 1 nëntor 2022. Pjesa tjetër e shoqërive UK Rajonale të krijuara do të fillojnë ushtrimin e aktivitetit me 1 janar 2023 me përjashtim të shoqërisë Rajonale UK Sarandë e cila ka planifikuar fillimin e ushtrimit të aktivitetit në 1 Mars 2023 për shkak të vonesave me nënshkrimin e marrëveshjes me shoqërinë UK Finiq. Janë akoma 11 bashki të cilat sipas parashikimeve të reformës në sektor përbëjnë 3 shoqëri UK Rajonale përkatësisht **UK Shkodër** e cila përfshinë bashkitë (Shkodër, Vau Dejës, Malësi e Madhe, Fushë Arrëz, Pukë) **UK Tiranë** e cila përfshinë bashkitë (Tiranë, Kamëz, Vorë) dhe **UK Vlorë** e cila përfshin bashkitë Vlorë, Selenicë, Himarë, që nuk kanë arritur të kryejnë marrëveshjet e bashkëpunimit edhe pse nga ana këshillave bashkiake të këtyre bashkive janë marrë vendimet përkatëse.

Ndërsa gjendja e performancës së shërbimit të furnizimit me ujë nga NjQV është analizuar nëpërmjet dy treguesve të raporteve të performancës:

- Furnizimi me ujë - orë ujë në ditë (ndryshimi në orë nga viti kaluar, pra 2022 / 2021 (tregues cilësi/mbulim shërbimi),
- Mbulimi i popullsisë me shërbimin e ujit të pijshëm (kundrejt popullsisë totale të bashkisë në %, standard/kërkesë ligjore për shërbimin).

Mbulimi me furnizim me ujë me 78% dhe kanalizime 54.4% është i pamjaftueshëm dhe pengon zhvillimin ekonomik, veçanërisht në zonat më të varfra urbane periferike. Në 2022, kohëzgjatja e furnizimit me ujë për qytetarët ishte për 16.3 orë në ditë, që është 0.9 orë më shumë se në vitin 2021. Ndërsa për treguesin e dytë për mbulimin e popullatës me shërbim me

RAPORT MBI QEVERISJEN VENDORE NË SHQIPËRI 2022

ujë ka qenë mesatarisht në nivelin 78% në vitin 2022, kundrejt 76.8% në vitin 2021 (me një rritje prej 1.2%). Duke iu referuar të dhënave të grumbulluara nga ERRU për vitin 2022, kohëzgjatja e furnizimit me ujë ka qenë mesatarisht 16.3 orë/ditë në 2022, ndërsa mbulimi i popullatës me FU ka qenë 78% në 2022.¹⁷ Ndërsa mbulimi me kanalizime ka qenë në nivelin 54.4% me një rritje të vogël krahasuar me 2021.¹⁸

Tabela 4. Treguesit e performancës për FU dhe Kanalizime, 2022. Burimi: ERRU

Nr	Treguesit e Performancës	Njësia e Matjes	Viti 2021	Viti 2022	Tendenca
1	Uji pa të ardhura	%	64.7	63.4	Rritje
2	Mbulimi i kostove O&M	%	103	90.5	Zbritje
3	Norma e arkëtimit Korrente	%	79.8	78.6	Rritje
4	Norma e Arkëtimit të Përgjithshëm	%	94.1	94.7	Rritje
5	Niveli i Matjes	%	80.7	82.8	Rritje
6	Efiçenca e Stafit	(Stafi 1000/ lidhje UK)	5.28/ 4.9 ¹⁹	4.66	Rritje
7	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	Orë/ditë	13.8	16.3	Rritje
8	Mbulimi me Furnizimin me Ujë	%	77	78	Rritje
9	Mbulimi me Kanalizime	%	51.9	54.4	Rritje

Referuar tabelës së mësipërme, vërehet se Treguesit Kryesorë të Performancës për vitin 2022 paraqiten të përmirësuar pothuajse në të gjithë treguesit me përjashtim të treguesit financiar Mbulimi i Kostove O&M, i cili ka një rënie të ndjeshme me 12.9% dhe që lidhet direkt me qëndrueshmërinë financiare të shoqërive UK. Treguesit e përmirësuar për vitin 2022, lidhen direkt me rritjen

¹⁷ ERRU, 2022, fq.50

¹⁸ Po aty, fq.50

¹⁹ Efiçenca e stafit 5.28 staf për 1000 lidhje përfshin edhe personelin roje të nënkontraktuar me privatën ndërsa 4.9 staf për 1000 lidhje UK nuk përfshin këto të fundit.

e cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj konsumatorëve dhe menaxhimin e mirë të shoqërive UK, si rritja e Normës së Arkëtimit Korrente dhe të Përgjithshme, Nivelit të Matjes, Mbulimit me Ujë, dhe Mbulimit me Kanalizime. Për vitin 2022, nëpërmjet AKUM-it, janë alokuar fonde për investime në sektor nga buxheti i shtetit në vlerën e rreth 8,5 miliard lekë (rreth 70.7 milion euro) dhe janë disbursuar 70.2 milion euro ose rreth 99.3% e fondit të akorduar për investime. Pjesa më e madhe e financimit në vitin 2022 ka qenë për objektet në vazhdim dhe vetëm 280.8 milion lekë (rreth 2.3 milion euro) janë financuar për objekte të reja. Gjithashtu në sektor janë financuar edhe 1,68 miliard lekë (rreth 14 milion euro) financime të huaja, kryesisht nga KfW në vazhdimësi të Programit të Infrastrukturës Bashkiake III, IV dhe V, Banka Botërore, SECO dhe SIDA, nga të cilat është disbursuar pothuaj e gjithë vlera (99.4%).

Megjithatë reforma sektoriale e UK-vë është parë si një hap mbrapa në reformën e decentralizimit dhe autonomisë vendore ku shumica e aksioneve të UK-e anojnë nga qeveria qendrore (51%) kundrejt bashkive (49%).

8.4 Rrugët rurale dhe infrastruktura

Ky funksion nënkupton realizimin e ndërhyrjeve në infrastrukturën e rrugëve për të arritur standarde optimale në tërësinë e rrugëve brenda juridiksionit të një bashkie që përfshin rrugët e qytetit brenda bashkisë dhe rrugët rurale, që bëjnë lidhjen e qytetit me qendrën e fshatit.


Në nivel vendor, ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrjetit rrugor sekondar dhe rrugëve lokale (*urbane dhe rurale ndërmjet fshatrave (ose terciare)*), si aset publik, është funksion i NjQV bazuar në Ligjin 139/2015, neni 23, pika 4, dhe Urdhër i Kryeministrit (nr. 127/2015) mbi masat për zbatimin e SNDQV dhe transferimin e gjashtë (6) funksioneve, një nga të cilët është funksioni i menaxhimit të rrugëve të kategorisë II dhe III, si dhe VKM nr. 915/2015 për transferimin e rrjetit rrugor rural dhe aseteve nga Këshilli i Qarkut tek bashkitë.

Gjatësia e përgjithshme e rrjetit rrugor të Shqipërisë është rreth 15,000 km dhe përfshin rrugët kombëtare, rajonale, lokale dhe urbane. Ministria

e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) është përgjegjëse për politikën dhe kuadrin rregullator dhe standardet teknike. Për sa i përket rregullimit institucional për administrimin dhe menaxhimin e rrjetit rrugor, Autoriteti Rrugor i Shqipërisë (ARRSH) është përgjegjës për 3606 km rrugë kombëtare dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore (NjQV) për 9400 km rrugë rajonale dhe lokale.

Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH) mbështet NjQV-të në zbatimin e projekteve të infrastrukturës rurale nëpërmjet financimit konkurrues të granteve nga qeveria dhe një sërë projektesh të tjera të financuara nga donatorët. Projekt i Rrugëve Dytësore dhe Lokale është bashkë financuar nga BERZH, EIB dhe KfW nëpërmjet një Huaje për Bashkëpunim Financiar që synon të përmirësojë infrastrukturën lokale, të rrisë aksesin në shërbimet dhe tregjet thelbësore, veçanërisht në zonat rurale, dhe në fund të kontribuojë për zbutjen e varfërisë dhe zhvillimin ekonomik.

Gjatë vitit 2022, transfertat totale për këtë funksion ishte 614,582,000 Lek²⁰ duke pësuar një rritje krahasuar me vitin 2021. Transferta specifike për rrugët pësoi një rritje me 4% të transfertës së përgjithshme me një rritje prej 2% krahasuar me 2021, si tregohet në grafikun 3.



Grafiku 3. Transferta për rrugët në 2022. Burimi: MFE

20 Ministria e Financave. Buxheti Vendor 2021


Referuar të dhënave parciale dhe nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, nga një total prej 9800 km rrugë dytësore dhe lokale, ka përfunduar faza e parë e inventarizimit me të dhëna të detajuara për rreth 4247 km, të identifikuar si rrugë kryesore të rrjetit rrugor rural. Ndërkohë është duke u zbatuar faza e dytë e inventarizimit dhe janë zhvilluar projekte teknike për 1200 km segmente rrugore të reja. Për më shumë, FSHZH ka trajnuar rreth 1000 punonjës të NjQV për funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor rural, duke u vendos në dizpozicion të NjQV dhe një soft për llogaritjen e buxhetit të mirëmbajtjes së rrjetit rrugor dytësor dhe lokal të bashkive.

Megjithatë në këndvështrimin tonë shqetësim ngelet mungesa e një inventari të detajuar të rrugëve lokale dhe të administruara nga pushteti vendor dhe investimeve përkatëse. Kjo do të mundësonte një transparencë më të lartë të investimeve dhe orientimit të politikave vendore për këtë funksion ku vendimmarrja është e bazuar në një sistem shume kriteresh dhe jo të preferencave politike.

8.5 Mirëmbajtja dhe ndërtimi i objekteve arsimore

Programi për mirëmbajtjen dhe ndërtimin e objekteve arsimore ka si burim financimi kryesisht të ardhurat që vijnë nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale për pagesat e personelit, transfertat e kushtëzuar për pagesën e nxënësve bursistë dhe transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme që bashkitë e përfitojnë bazuar në numrin e nxënësve fakt në shkollën e mesme të përgjithshme. Shpenzimet neto janë shpenzime që mbulohen nga të ardhurat e veta të bashkisë dhe përdoren për të siguruar dhe mirëmbajtur objektet shkollore dhe paguar rrogat e stafit mbështetës. Në këndvështrimin e të ardhurave nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale gjatë 2022 vërejmë një reduktim krahasuar me 2021 në stafin mbështetës dhe në arsimin parauniversitar.²¹

21 MF. Buxheti Vendor 2022.



Grafiku 4. Paraqet peshën specifike të shpenzimeve vendore sipas funksioneve në 9 mujorin 2022 kundrejt 2021.

Ndërsa në statistikën e pjesshme të publikuar nga Ministria e Financave për 9 mujorin e 2022, (Grafiku 4 më sipër) vërejmë se shpenzimet e përgjithshme për arsimin zënë një peshë prej 20% të shpenzimeve vendore duke shënuar një reduktim me 1% krahasuar me të njëjtën periudhë të 2021.²² Por në fakt nga analiza e shpenzimeve në bazë të këtij funksioni vihet re se kemi 6% rritje të transfertës nga buxheti qendror për këtë funksion dhe një reduktim me -3% nga të ardhurat e veta për shpenzime në këtë sektor. Prsh, bashkia Tiranë ka financuar 36% të financimeve për funksionin e “Argëtim, Kultura dhe Feja”.²³

8.6 Shërbimet sociale në bashki

Në Shqipëri ofrohen 493 shërbime sociale, publike, jo publike dhe të formës së përzier, të cilat sigurohen nga 339 institucione, përkatësisht 122 publike dhe 217 jo publike. Siç tregon tabela më poshtë, 46% janë shërbime sociale

22 MF. Raporti i monitorimit të buxhetit vendor 9-mujori 2021. financa.gov.al

23 Po këtu, fq.21

publike, kundrejt 42% që janë shërbime jo publike. Vetëm 12% shërbimeve sociale janë të formës së përzier, publik edhe jo publike.

Tabela 5. Shërbimet sociale të ofruara në bazë qarku. Burimi:PNUD

Qarku / Lloji	Publike	Jo publike	Përzier	Shuma
Berat	19	3	1	23
Durrës	23	18	4	45
Dibër	5	10	3	18
Elbasan	31	41	0	72
Fier	16	4	3	23
Gjirokastër	26	10	2	38
Kukës	8	2	2	12
Korçë	17	16	6	39
Lezhë	5	16	7	28
Shkodër	9	15	19	43
Tiranë	44	65	5	114
Vlorë	24	7	7	38
Shumë	227	207	59	493
Në %	46%	42%	12%	100%


Bashkitë janë financuesit kryesorë të shërbimeve të institucioneve publike, 54%, të pasuara nga format “mikse” të financimit të shërbimeve, përkatësisht 24%. Ministria (niveli qendror i administrimit) financon 19% të shërbimeve të institucioneve publike.²⁴ Ndërsa përsa i përket shpërndarjes gjeografike, numri më i madh i shërbimeve ofrohet në qarkun e Tiranës (114) i cili pasohet nga Elbasani (72), Durrës (45), Shkodër (43), Korçë (39), Vlorë (38), Gjirokastër (38), Lezhë (28), Fier (23), Berat (23), Dibër (18) dhe Kukës (12). Duke i analizuar të dhënat e numrit të shërbimeve sipas popullsisë për 10,000 banorë (duke qenë se nuk ka standard zyrtar) është përdorur vetëm numri i popullsisë, ku del qartë se qarku Gjirokastër ka një mesatare më të lartë me 5.26 për 10.000 banorë dhe Fieri me 0.74/10.000 banorë.

24 Raporti-SSS-final-OK.pdf (undp.org)

Ligji nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale”, neni 8 përcakton kategoritë e përfituesve për aftësinë e kufizuar dhe invalidë të punës. Ndërsa VKM nr.597/2019 “Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën Ekonomike”, përcakton rregullat për aplikim për të përfituar nga skema e ndihmës ekonomike dhe mënyrën e ankimimit. Këshilli bashkiak ka të drejtë të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% dhe ose me fonde të tjera buxhetore vendore, për ato familje që s’kanë përfituar nga skema e NE.

Nëse do analizohen shërbimet sociale sipas kategorisë si tregohet në Grafikon 4, analiza e thelluar edhe sipas kriterit të “Shërbimeve sipas grupeve përfituese” tregon se:

- në 54 bashki ose thujse në 90% e të gjitha bashkive të vendit, mungojnë shërbimet për të rinj të përjashtuar, për viktimat e trafikimit si edhe të rinjtë në konflikt me ligjin.
- 49 bashki ose 80% e të gjitha bashkive të vendit nuk kanë shërbime për minoritetet etnike, Romë dhe Egjiptiane.
- 47 bashki ose 77% e bashkive të vendit nuk kanë shërbime për të rritur me AK,
- 36 bashki ose thujse 60% e bashkive të vendit nuk kanë shërbime për të moshuar.
- 32 bashki ose mëse 50% e bashkive të vendit nuk kanë shërbime për fëmijë jashtë kujdesit prindëror,
- ndërsa rreth 30% e bashkive të vendit nuk ofrojnë shërbime për fëmijë me AK.



Grafiku 5. *Kategoria e shërbimeve sociale në nivel vendor. Burimi: PNUD*

Shpërndarja e shërbimeve sipas grupeve të përfituesve në nivel bashkie është analizuar nga studimi i PNUD (Hartëzimi i shërbimeve sociale në nivel bashkie) në Tabelën 6, ku rezulton se 41 bashki ose (60% e bashkive) ofrojnë shërbime për një deri në katër (30%) grupe në nevojë. Rreth 25% e bashkive ofro shërbime për 50 deri 75% të grupeve në nevojë, ndërsa vetëm 7% e bashkive (4 bashki, përkatësisht Durrës, Elbasan, Shkodër dhe Tiranë) ofrojnë shërbime për mbi 80% të grupeve në nevojë.


Tabela 6. *Ofrimi i shërbimeve sipas bashkive.*

Bashki që ofrojnë shërbime për:	Numri i bashkive	Bashkitë
Asnjë grup në nevojë/ asnjë shërbim	5	Rrogozhinë, Libohovë, Tepelenë, Himarë, Delvinë
Një grup në nevojë	6	Peqin, Selenicë, Pukë, Fushë-Arrëz, Memaliaj, Dimal
Dy grupe në nevojë	15	Vorë, Dropull, Mirditë, Kuçovë, Skrapar, Bulqizë, Klos, Cërrik, Tropojë, Has, Gramsh, Finiq, Patos, Divjakë, Mallakastër

RAPORT MBI QEVERISJEN VENDORE NË SHQIPËRI 2022

Tre grupe në nevojë	9	Kavajë, Mat, Belsh, Maliq, Pustec, Malësi e Madhe, Konispol, Lushnjë, Poliçan
Katër grupe në nevojë	7	Kamës, Përmet, Librazhd, Kolonjë, Devoll, Pogradec, Roskovec
Pesë grupe në nevojë	6	Këlcyrë, Berat, Dibër, Përrenjas, Sarandë, Vau i Dejës
Gjashtë grupe në nevojë	2	Shijak, Kurbin
Shtatë grupe në nevojë	2	Krujë, Kukës
Tetë grupe në nevojë	4	Lezhë, Korçë, Vlorë, Fier
Nëntë grupe në nevojë	1	Gjirokastër
Njëmbëdhjetë grupe në nevojë	3	Durrës, Elbasan, Shkodër
Të gjitha grupet	1	Tiranë
Bashki gjithsej	61	

Gjatë vitit 2022 vihet re një rënie të numrit të përfituesve me sistemin e pikëzimit krahasuar me vitin 2021 me një diferencë prej -8645 ndërsa kemi një rritje me 220 persona të shtuar në skemën e 6%, e cila përcaktohet nga Këshilli bashkiak. Në tabelë pasqyrohet mesatarja vjetore e përfituesve sipas sistemit të pikëzimit 2020, 2021 dhe 2022.



Grafiku 6. NE sipas procesit me pikëzim dhe sipas 6%.

Ndërsa në vitin 2022, familjet e trajtuara me fondin 6% janë 4588 që është më e madhe se mesatarja e viteve paraardhëse siç mund të shikohet në grafikonin më sipër. Në përgjithësi skema e ND qoftë me pikëzim qoftë ajo me 6% ka qenë dinamike dhe ndikim ka patur dhe VKM nr.85 10.02.2021 që mundësoi dyfishimin e ndihmës ekonomike në 6 mujorin e parë për të zbutur efektet e COVID-19. Ndryshimet në numrin e përgjithshëm vijnë dhe si pasojë e shtesës së dhënë gjatë pandemisë covid-19 në vitin e kalur dhe gjithashtu rritjes me 2% e nr. të familjeve përfituese të skemës së NE. Numri mesatar i individëve pjesë e skemës së PAK për vitin 2022 (pa përfshirë kujdestar dhe invalid) ka qenë 71.056 persona me AK.

Siç shikohet nga statistikat, numri i personave është ulur krahasuar me 2021. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 606 Fond për financimin e Shërbimeve të përkujdesit në bashki e qarqe është: (2020) 94.481.128 lekë ose 69%; (2021) 145.188.353 lekë ose 78.83%, (2022) 29,272,952,722 lekë ose 99%.

8.7 Ndërtimet post tërmetit në 11 bashkitë e prekura

Në vijim të ecurisë dhe planit të rindërtimit të objekteve publike dhe strehimit me banesa të reja, është e vështirë të gjendet një informacion i saktë rreth progresit të arritur në statistika konkrete sasiore ose cilësore. Në total kostoja për ndërhyrjet si pasojë e tërmetit u llogaritën në 1.076 miliardë euro ose 131 miliardë lekë të cilat u evidentuan si nevoja për strehim, infratsrukturë urbane, godina publike kryesisht shëndetësi dhe arsim. Në funksion të kësaj analize ne do të analizjmë fondin për arsim, duke qenë së të dhënat janë të publikuara nga programi i PNUD, EU4School, e financuar nga BE-ja dhe PNUD.


Qeveria ka identifikuar 63 objekte arsimore të cilat kanë nevojë për rindërtim ose ndërtim nga e para në 11 bashkitë specifike. Në këtë kontekst, është shumë e qartë procesi i marrë përsipër nga Bashkimi Evropian përmes programit EU4Schools (BE për Shkollat) ku nga 63 godina arsimore të përfshira në programin e rindërtimit:

- Kanë përfunduar 61 projektet teknike nga 63;
- Kanë përfunduar ndërtimi i 39 prej tyre;
- 15 objekte janë në proces rindërtimi;
- Aktualisht janë firmosur 58 kontrata ndërtimi nga 63 objektet²⁵.

Grafiku 7 më poshtë prezanton numrin e shkollave sipas secilës bashki dhe statusin e tyre. Situata e post tërmetit është e lidhur specifikisht me 11 bashkitë e prekura të cilat janë: Durrës, Krujë, Kamëz, Tiranë, Kurbin, Kavajë, Rrogozhinë, Lezhë, Shijak, Vorë dhe Mirditë.²⁶

25 <https://eu4schoolsportal.al/progress.aspx>

26 <https://portavendore.al/2021/05/25/sfidat-e-emergjencave-civile-cfare-ndryshoi-pas-termetit-e-deri-ne-ditet-tona/>;




Grafiku 7. Nr. i godinave arsimore sipas statusit të tyre. Burimi: EU4Schools

Sipas Opendata Albania, në vitin e katërt pas fatkeqësisë (mars 2023), Qeveria dhe Shteti Shqiptar kanë buxhetuar, alokuar dhe konsoliduar total 75 miliard lekë. Konkretisht në 2020 u konsoliduan 16.6 miliard lekë, në 2021 janë 29.5 miliard dhe në vitin 2022 janë 28.9 miliard lekë shpenzime të realizuara.

Në Buxhetin fillestar të Shtetit për vitin 2022, ishin planifikuar 20 miliard lekë për Fondin e Rindërtimit. Ky ligj ka ndryshuar 4 herë nëpërmjet akteve normative, por vetëm akti normativ i fillim dhjetorit (nr. 17) preku edhe Fondin e Rindërtimit. Përkatësisht në aktin normativ nr. 17 u shënuar shtesë në Fondin e Rindërtimit me 12.4 miliard lekë, 62% më shumë se fillestari, duke arritur në 32.4 miliard lekë.

Nga 32.4 miliard lekë të planifikuara për tu alokuar për fondin e rindërtimit në vitin 2022 u konsoliduan 89% e tyre ose 28.9 miliard lekë. Konsolidimi i Fondit të Rindërtimit ka ardhur në përmirësim të vazhdueshëm nga viti në vit, por nuk është shënuar realizim mbi 90%, duke shfaqur problematika në ecurinë e vetë procesit të rindërtimit.²⁷

27 Fondi i Rindërtimit Plan Buxhetim dhe Realizim, 2020 – 2023, ndryshimet në Buxhetin e Shtetit – Open Data Albania (ndiqparate.al)



Grafiku 8. Fondi i ndërtimit në miliardë lekë.

Ndërsa, programi shtetëror për rindërtimin e strehimeve dhe banesave është i paqartë. Sipas Opendata Albania, nga monitorimi i dy rrymave kryesore të shpenzimeve në tendera për programin e rindërtimit në nivel bashkie dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit janë 856 tendera të firmosura me qeverinë shqiptare me një fond limit total të tenderuar 96.65 miliardë lekë kundrejt 627 tendera të raportuar në 2021 me një fond limit 71.8 miliardë lekë.

- 611 tendera janë shpallur nga 14 bashkitë që u prekën nga tërmeti me një fond 28.9 miliardë
- 245 tendera të shpallur nga FSHZH më një fond prej 46.4 miliardë.

Sipas OpenData Albania dhe programit “Ndiq paratë”, në 2022 një pjesë e madhe e tenderave janë realizuar përmes Proçedurave të Kufizuara ose Negocimit pa Shpallje.²⁸ Kjo proçedurë është ndjekur kryesisht për tenderat e rindërtimit duke hedhur më shumë dritëhije për transparencën e përgjithshme të rindërtimit dhe në nivel vendor.²⁹

28 OpenData. Prokurime publike, procedura pa konkurim në numër dhe vlerë tenderimi. 2 Mars 2022; <https://ndiqparate.al/?p=15445>

29 Fondi i Rindërtimit Plan Buxhetim dhe Realizim, 2020 – 2023, ndryshimet në Buxhetin e Shtetit – Open Data Albania (ndiqparate.al)


8.8 Bujqësia dhe zhvillimi rural

Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural rregullohen në ligjin 135/2015 në nenin 26 i cili liston kompetencat specifike në këtë drejtim si më poshtë:

- Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- Administrimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- Krijimin dhe administrimin e sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural, sipas legjislacionit në fuqi.
- Krijimin dhe administrimin e skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural, të financuara nga buxheti lokal dhe/ose me bashkëfinancim nga të tretët, duke garantuar akses të balancuar gjinor.


Këto kompetenca janë të shprehura dhe në programin buxhetor ku bashkia planifikon shpenzimet kryesisht në 3 drejtime kryesore: a) menaxhim i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit; b) shërbime bujqësore, inspektim dhe mbrojtje e konsumatorit; c) administrimi i pyjeve.

Grafiku 9 më poshtë paraqet një panoramë të transfertës specifike në vitin 2022 ku ka një rritje në të dyja funksionet. Siç shikohet në grafikun më poshtë, specifikisht administrimi i pyjeve dhe pati një rritje me 18.3% dhe 6.5% në fushën e ujitjes dhe kullimit krahasuar me 2021. Përsa i përket vaditjes në rang vendi Shqipëria ka 620 rezervuarë por vaditet 50% e sipërfaqes që vaditej para viteve '90.



Grafiku 9. Transferta në fushën e pyjeve dhe ujitjes dhe kullimit.

Pavarësisht kësaj rritje, shpenzimet e këtij funksioni bien në kategorinë 04 çështje ekonomike dhe në vitin 2022 vihet re një rënie e peshës së shpenzimeve për funksionet e kësaj kategorie prej 287 milionë lekë krahasuar me 2021. Sipas MFE çështjet ekonomike ku bën pjesë dhe kodi për ujitjen dhe kullimin apo administrimi i pyjeve zë 16% të peshës së përgjithshme të shpenzime funksionale të bashkisë kundrejt 18% që ishte në 2021.



Në përgjithësi, funksioni i bujqësisë dhe zhvillimit rural është totalisht i menaxhuar nga Ministria e Bujqësisë, përmes AZHBR apo agjencie qendrore. Qeveria vendore, në përgjithësi nuk ka shumë kompetenca në fushën e bujqësisë. Shërbimi i ekstensionit ose këshillimit për fermerët ku pushteti vendor do të luajë një rol kyç është i papërfillshëm dhe vazhdon të jetë i centralizuar.

8.9 Përfundime mbi funksionet

Qeveria vendore vazhdon dhe sot të mos buxhetojë një sërë funksionesh të deleguara. Nga vlerësimi i shpenzimeve buxhetore sipas natyrës ekonomike funksione si “Ndërgjegjësimi mjedisor” apo “Programi për mbrojtjen e natyrës” vazhdojnë të jenë dhe sot me buxhet të ulët. E njëjta situatë paraqitet dhe për llogarinë ekonomike të lidhur më fushën e bujqësisë dhe zhvillimin rural.

Gjatë 2022 ka pasur sërish rritje të financimit prej buxhetit në nivelin vendor në masën prej +22% krahasuar me 2020, por në pak raste referohet përmirësim i cilësisë së shërbimit apo zgjerim i mbulimit me të. Ndërkohë bashkitë referojnë se arrijnë të grumbullojnë tarifën e pastrimit në masën 60%.

Në fushën e ujësjellës kanalizime qeveria vendore nuk ka bërë ndonjë progres të dukshëm, por pavarësisht kësaj, reforma sektoriale e UK-vë është parë si një hap mbrapa në reformën e decentralizimit dhe autonomisë vendore ku shumica e aksioneve të UK-e anojnë nga qeveria qendrore (51%) kundrejt bashkive (49%).

Situata e furnizimit me ujë është 78% e popullatës dhe mesatarja ditore është 16.3 orë/ditë. Ndërsa mbulimi kombëtar në fushën trajtimit të ujërave është 54.4% çka dëshmon se progresi në këtë sektor kërkon investime kapitale qendrore.

9. Performanca Buxhetore e Njësive të Qeverisjes Vendore për vitin 2022

9.1 Hyrje

Ecuria e zbatimit të buxhetit të Njësive të Qeverisjes Vendore (NjQV) përgjatë vitit 2022 është karakterizuar nga një trend pozitiv si nga kahu i të ardhurave dhe ai i shpenzimeve. Kjo ecuri ishte e brenda pritshmërive të përgjithshme për një zbutje të mëtijshme të efekteve negative nga dy fatkeqësitë natyrore që goditën vendin tonë në mënyrë të njëpasnjëshme gjatë fundit të vitit 2019 (tërmeti i 26 Nëntorit 2019) dhe fillimit të vitit 2020 (pandemia COVID-19) në ekonominë e vendit. Në këtë ecuri kanë ndikuar dhe efektet e luftës në Ukrainë, të cilat janë reflektuar në një pakësim të ofertës globale të disa mallrave bazë duke çuar në një rritje të fortë të nivelit të përgjithshëm të çmimeve (inflacionit) në vendin tonë.³⁰

Tabela 7. Ecuria e zbatimit të buxhetit të Njësive të Qeverisjes Vendore.


në milionë lekë

Emërtimi	2020 Fakt	2021 Fakt	2022 i rishikuar	2022 Fakt	Ndryshimi 2022 rishikuar vs. 2022 fakt (në %)	Krahasimi 2022 fakt vs. 2021 fakt (në %)
Të ardhurat tatimore vendore	21,975	26,666	27,632	27,638	0.02%	3.65%
Shpenzimet vendore (total)	51,626	52,593	61,640	58,694	-4.78%	11.60%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, www.financa.gov.al

30 Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal 2024-2026 <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2023/02/Kuadri-Makroekonomik-e-Fiskal-2024-2026.pdf>

Tabela e mësipërme pasqyrohet grafikisht më poshtë.



Grafiku 10. *Krahasim i të ardhurave dhe shpenzimeve 2021/2022*

Siç evidentohet, të ardhurat faktike nga taksat për vitin 2022 rezultuan thuajse të njëjta me planin e rishikuar të po të njëjtës periudhë. Nëse do ta krahasonim me të njëjtën periudhë të vitit 2021, të ardhurat e realizuara nga taksat për vitin 2022 rezultojnë me një rritje prej rreth 972 milionë lekë ose 3.65% më shumë.

Nga ana tjetër, shpenzimet vendore për vitin 2022 rezultuan me një rritje të konsiderueshme prej 11.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021. Nga ana tjetër, nëse totali i shpenzimeve vendore faktike për vitin 2022 do krahasohej me planin e rishikuar të shpenzimeve për vitin 2021 ku vërehet një mos-realizim prej 2.9 miliardë lekë më pak. Në vijim, do të prezantohet ecuria faktike e treguesve buxhetorë 2022 për NjQV duke ofruar dhe një krahasim me ecurinë e vitit të mëparshëm.

9.2 Burimet financiare

Burimet financiare totale të qeverisjes vendore deri në fund të vitit 2022 regjistruan një vlerë prej 63.6 miliardë lekë, në rritje mer rreth 6.8% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Tabela 8. Burime financiare të NjQV sipas kategorive (në lekë).

	2021 Fakt	2022 Fakt	Diferenca (absolute)	Diferenca (në %)
Të ardhurat e veta	29,655,841,209	31,725,743,040	2,069,901,831	6.98%
Transferta e Pakushtëzuar dhe Specifike	27,239,821,876	28,863,571,194	1,623,749,318	5.96%
Taksat e Ndara	2,694,907,071	3,030,878,854	335,971,783	12.47%
Totali	59,590,570,156	63,620,193,088	4,029,622,933	6.76%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Sikurse evidentohet nga Tabela 8, të ardhurat nga burimet e veta janë faktori kryesor i kësaj rritjeje duke rezultuar me rreth 2 miliardë lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2021 ose me një rritje prej 7%. Ndërkohë që transferta e pakushtëzuar dhe specifike vijon të ketë rritje përgjatë kësaj periudhe, duke shënuar një rritje prej 1.6 miliardë lekë ose rreth 6% më shumë se viti 2021. Të ardhurat nga taksat e ndara u rritën me rreth 12.5% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Në grafikun më poshtë pasqyrohet pesha e secilit burim të të ardhurave krahasuar me totalin për vitin 2022. 45.3% e të ardhurave janë realizuar nga transferta e pakushtëzuar dhe specifike dhe 4.76% nga taksat e ndara. Peshën më të madhe e mbajnë të ardhurat e veta me 49.9%.



Grafiku 11. Pesha e burimeve të të ardhurave kundrejt totalit

9.3 Ecuria e të ardhurave nga burimet e veta vendore sipas NjQV

Të ardhurat nga burimet e veta vendore (taksa dhe tarifa vendore, veprimtari me asete dhe të tjera) regjistruan një vlerë prej rreth 31.7 miliardë lekë, me një rritje prej rreth 7% në terma vjetorë, ose rreth 2 miliardë lekë më shumë nga niveli i regjistruar në vitin e mëparshëm.


Sipas kategorive përbërëse, performanca pozitive e të ardhurave nga burime të veta është përcaktuar kryesisht nga kontributi i të ardhurave nga taksat (+1.7%) dhe tarifat (+11.3%) vendore në këtë periudhë. Në zërin e të ardhurave nga taksat, vërehet që ndikimin më të madh në këtë rritje e kanë dhënë taksa e ndikimit në infrastrukturë (+680 milionë lekë) dhe taksa e hotelit (+104 milionë lekë). Ndërkohë që rritja e të ardhurave nga tarifat është kushtëzuar kryesisht nga performanca pozitive e të ardhurave nga tarifat e shërbimeve publike vendore (+446.1 milionë lekë) dhe nga të ardhurat nga tarifat për shërbimet administrative dhe të tjera (612.1 milionë lekë).

Tabela 9. Të ardhurat nga burimet e veta sipas kategorive (në lekë).

Emërtimi	2021	2022	Diferenca (absolute)	Diferenca (në %)
Të ardhurat nga Taksat	17,972,053,968	18,280,021,325	307,967,358	1.7%
Taksa e tatime mbi biznesin e vogël	388,404,555	88,319,432	-300,085,123	-77.3%
Taksa mbi pronën	5,164,837,482	5,088,732,958	-76,104,524	-1.5%
<i>Taksa mbi tokën bujqësore</i>	583,939,584	582,822,445	-1,117,139	-0.2%
<i>Taksa e ndërtesës</i>	4,580,897,898	4,505,910,513	-74,987,385	-1.6%
<i>Taksa mbi tokën urbane</i>	0	0	0	0.0%
Taksa e hotelit	186,414,022	290,470,126	104,056,104	55.8%
Taksa e ndikimit në infrastrukturë	9,455,794,488	10,135,970,015	680,175,527	7.2%
Taksa mbi transferimin e pronësisë së paluajtshme	703,801,123	799,912,989	96,111,866	13.7%
Taksa e tabelës	331,002,731	361,888,061	30,885,330	9.3%
Të tjera	1,741,799,566	1,514,727,744	-227,071,822	-13.0%
Të ardhura nga Tarifat	11,022,085,847	12,267,891,943	1,245,806,096	11.3%
Të ardhura nga tarifat e shërbimeve publike vendore (pastrimi, gjelbërimi etj.)	4,953,357,991	5,399,484,879	446,126,888	9.0%
Të ardhura nga tarifat e shërbimeve për zënien e hapësirave publike	1,432,501,153	1,620,048,490	187,547,337	13.1%
Të ardhura nga tarifat për shërbimet administrative dhe të tjera	4,636,226,702	5,248,358,574	612,131,871	13.2%
Huamarrja vendore neto	65,429,342	81,846,631	16,417,288	25.1%
Të ardhura vendore të tjera	596,272,052	1,095,983,141	499,711,089	83.8%
Totali	29,655,841,209	31,725,743,040	2,069,901,831	7.0%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Portali i Financave Vendore
www.financatvendore.al

Grafiku më poshtë pasqyron numrin e bashkive sipas diferencave në të ardhurat prej taksave, tarifave dhe të ardhurave të tjera për vitin 2022 duke e krahasuar me vitin 2021. 40 nga 61 bashki, kanë arritur që të kenë një performancë pozitive të të ardhurave për këtë periudhë, ndërkohë që 21 bashkitë e mbetura kanë pasur një performancë negative në këtë drejtim. Kontributin kryesor në këtë rritje e japin bashkitë e cilësuara si “të mëdha”: bashkia Tiranë (+514.9 milionë lekë), bashkia Vlorë (+236.2 milionë lekë) dhe bashkia Kamëz (+223 milionë lekë). Nga ana tjetër, performanca negative i atribuohet sërish bashkive të ashtuquajtura “të mëdha” dhe “të vogla” si p.sh. bashkia Lezhë (-106.4 milionë lekë), bashkia Durrës (-67.8 milionë lekë), bashkia Finiq (-38.7 milionë lekë) dhe bashkia Mallakastër (-41.5 milionë lekë).



Grafiku 12. Të ardhurat nga burimet e veta krahasuar me 2021 sipas kategorive (në lekë)

Grafiku pasqyron dhe performancën e bashkive krahasuar me vitin pasardhës dhe në tre kategoritë e të ardhurave të veta, taksa, tarifa dhe të tjera. Kështu, 31 bashki kanë mbledhur më shumë taksa gjatë 2022 dhe 36 të ardhura të tjera.

Grumbullimi i tarifave shënon përmirësimin më të dukshëm me 49 bashki që kanë performuar më mirë krahasuar me 2021.


Në vijim, do të marrim në analizë ecurinë e mbledhjes së taksës së ndërtesës dhe taksës së ndikimit në infrastrukturë për 61 bashkitë e marra në analizë. Nga grafiku më poshtë rezulton se 30 bashki kanë performuar pozitivisht në mbledhjen e taksës së ndërtesës, ku spikasin bashkia Kavajë (+34.5 milionë lekë), bashkia Shkodër (+28.5 milionë lekë), bashkia Kamëz (22.7 milionë lekë) dhe bashkia Himarë (+14.1 milionë lekë). Në terma relativë vlen të përmenden bashkia Himarë (+100.7%) dhe bashkia Kavajë (+46.6%) të cilat kanë pësuar një rritje të konsiderueshme të të ardhurave nga kjo taksë. Gjithsesi kjo performancë pozitive e arritur në këto bashki, nuk ka arritur dot që të përmbysë trendin negativ të vërejtur në 31 bashkitë e mbetura, të cilat kanë kontribuar që të ardhurat nga kjo taksë në total për vitin 2022 të rezultojnë me rënie prej 1.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021, ku spikasin bashkia Durrës (-75.7 milionë lekë), bashkia Tiranë (-66.3 milionë lekë), bashkia Mallakastër (-20.2 milionë lekë) dhe bashkia Fier (-14.7 milionë lekë).



Grafiku 13. Taksa e ndërtesës krahasuar me 2021.

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Portali i Financave Vendore
www.financatvendore.al

Lidhur me ecurinë e të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë të ilustruar në grafikun më poshtë, performanca pozitive e vërejtur përgjatë vitit 2022 i atribuohet 34 bashkive e më së shumti bashkive Tiranë (+112.1 milionë lekë), Kamëz (+132.7 milionë lekë), Sarandë (+139.8 milionë lekë), Vlorë (+184.4 milionë lekë) dhe Shkodër (55.5 milionë lekë). Ndërkohë që evidentohen një numër bashkish si bashkia Lezhë (-106 milionë lekë), bashkia Korçë (-18.6 milionë lekë) dhe bashkia Kurbin (-14.3 milionë lekë) të cilat kanë performuar dobët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Kjo mund të shpjegohet me faktin se të ardhurat nga kjo taksë janë të varura ekskluzivisht nga kërkesa për leje ndërtimi si dhe nga miratimi i tyre nga NjQV, ç’ka e bën këtë taksë jo fort të parashikueshme dhe për rrjedhojë me karakter të ç’rregullt. Duke qënë se për disa nga bashkitë e marra në analizë, të ardhurat nga kjo taksë kanë një përpjesë të rëndësishme në totalin e të ardhurave nga taksat vendore, duhet që këto bashki të jenë të kujdesshme në planifikimin e të ardhurave nga kjo taksë në periudhat afatmesme në mënyrë që të mos hasin situata të “parashikimeve tejte optimiste” që mund të konkretizojnë mundësinë e krijimit të detyrimeve të prapambetura në krahun e shpenzimeve buxhetore të tyre.



Grafiku 14. Taksa e ndikimit në infrastrukturë krahasuar me 2021.

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Portali i Financave Vendore
www.financatvendore.al

9.4 Shpenzimet e Njësive të Qeverisjes Vendore

Në kahun e shpenzimeve të kryera nëpërmjet burimeve të veta³¹, 61 bashkitë shpenzuan rreth 58.4 miliardë lekë në vitin 2022. Krahasuar me një vit më parë, u shpenzuan rreth 6.2 miliardë lekë më shumë ose 11.9%. Ky trend pozitiv vërehet në të treja nën-grupet e shpenzimeve, ku spikasin shpenzimet operative dhe të tjera të cilat kanë rezultuar me rreth 25.1% më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar.

Tabela 10. Shpenzimet e NjQV nga burimet e veta (në lekë).

	Fakt 2021	Fakt 2022	Diferenca (absolute)	Diferenca (në %)
Shpenzime nga burimet e veta	52,167,376,349	58,390,445,399	6,223,069,050	11.93%
Paga dhe sigurime	23,926,557,986	25,019,411,714	1,092,853,729	4.57%
Operative dhe të tjera	17,361,198,466	21,725,715,471	4,364,517,005	25.14%
Kapitale	10,879,619,897	11,645,318,213	765,698,316	7.04%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Portali i Financave Vendore www.financatvendore.al

Ecuria e shpenzimeve sipas Njësive të Qeverisjes Vendore

Nga analizimi i të dhënave për shpenzimet totale të kryera nga 61 bashkitë në vitin 2022 (krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021), konstatohet një performancë në tërësi pozitive ku 52 nga 61 bashki kanë shpenzuar më shumë në vitin 2022 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Nga 9 bashkitë e evidentuara të cilat kanë një performancë negative në këtë drejtim, spikat bashkia Tropojë me -55 milionë lekë dhe bashkia Gramsh me -45.1 milionë lekë krahasuar me vitin 2021, pavarësisht faktit që të dyja këto bashki kanë performuar pozitivisht në kahun e te ardhurave gjatë vitit 2022


31 Këtu përfshihen të ardhurat nga taksat dhe tarifatat, taksat e ndara dhe transfertat e pakushtëzuar dhe specifike

krahasuar me vitin 2021. Vlen të theksohet gjithashtu se bashkia Tiranë ka peshën më të madhe të performancës pozitive në totalin e shpenzimeve të 61 bashkive për vitin 2022 me 1.7 miliardë lekë më shumë se viti 2021.

9.5 Detyrimet e Prapambetura të NjQV

Nga të dhënat e publikuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, vërehet se në fund të vitit 2022, totali i detyrimeve të prapambetura të NjQV arrin rreth 5.9 miliardë lekë, duke shënuar njëkohësisht një ulje prej 621.6 milionë lekë krahasuar me vitin 2021. Gjithsesi, performanca e 61 bashkive në këtë aspekt është mikse, ku referuar të dhënave vërehet se 14 prej 61 bashkive e kanë shtuar vlerën e detyrimeve të prapambetura ku spikasin bashkia Tiranë (+526.5 milionë lekë), bashkia Dibër (+251.9 milionë lekë), bashkia Pustec (+145.6 milionë lekë) dhe bashkia Devoll (+63.9 milionë lekë). Nga ana tjetër, vërehet një ecuri pozitive në shlyerjen e detyrimeve të prapambetura nga bashkia Malësia e Madhe (-253.8 milionë lekë), bashkia Durrës (+196.3 milionë lekë), bashkia Lezhë (-183.6 milionë lekë), bashkia Belsh (-141.4 milionë lekë) dhe bashkia Berat (-134.6 milionë lekë). Vlen të përmendet fakti që bashkia Këlcyrë dhe bashkia Patos për të dytin vit rradhazi nuk krijojnë asnjë detyrim të prapambetur ndaj palëve të treta.


Në analizën e komponentëve kryesorë të detyrimeve të prapambetura të evidentuara deri në fund të 2022 sipas grafikut më poshtë, vërehet se më shumë se gjysmën e totalit të detyrimeve të prapambetura e zënë detyrimet ndaj palëve të treta për projekte të investimeve publike (2.9 miliardë lekë). Ndërkohë që detyrimet që burojnë nga shërbimet e kryera nga palë të treta si dhe për vendime gjyqësore kapin 593 milionë lekë dhe 422 milionë lekë respektivisht. Në zërin “Të tjera”, me një total prej 1.5 miliardë lekë, pjesën dërrmuese e zënë detyrimet e prapambetura të energjisë elektrike të NjQV ndaj OSHEE sh.a.



Grafiku 15. Stoku i detyrimeve të prapambetura sipas zërave

Në raport me shpenzimet faktike të kryera nga 61 bashkitë nga burimet e veta, evidentohet se 10 nga 61 bashkitë e marra në analizë ndodhen në situatën e Vështirësisë Financiare të përcaktuar në nenin 56 të ligjit nr.68 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, duke qënë se detyrimet e prapambetura të tyre e tejkalojnë kufirin e 25% të shpenzimeve vjetore. Ndërkokë që bashkia Pustec (169%) përmbush kriterin e gjendjes së vështirësisë serioze financiare të përcaktuar në nenin 57 të ligjit të sipërcituar, pasi detyrimet e tyre të prapambetura zënë mbi 80% të shpenzimeve vjetore për vitin 2021. Referuar tabelës më sipër, bashkia Pustec pjesën më të madhe të detyrimeve të prapambetura i ka akumuluar ndaj palëve të treta për projekte të investimeve publike (146 milionë lekë). Pavarësisht se vlerat relative të detyrimeve të prapambetura për bashkitë Kavajë (74.8%) dhe Vorë (68.4%) janë poshtë nivelit prej 80% të kufirit ligjor të sipërcituar, këto

bashki duhet të bëjnë përpjekje më të mëdha si në kahun e të ardhurave dhe në atë të shpenzimeve për të ulur më tej këtë nivel të lartë detyrimesh përgjatë vitit 2023 e në vijim.



Grafiku 16. Situata financiare e bashkive, 2022

Për këto dy bashki, në këtë nen parashikohen hapat vijues për të mundësuar daljen nga situata e vështirësisë serioze financiare:


“...Ministria e Financave, me marrjen e njoftimit nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore ose kur e konstaton vetë, i propozon Këshillit të Ministrave masat për daljen nga situata e vështirësisë serioze financiare. Në këtë rast, Këshilli i Ministrave vendos:

- a) *të japë mbështetje financiare në formën e ndihmës apo huas, duke përcaktuar edhe planin për daljen e njësisë së vetëqeverisjes vendore nga situata e vështirësisë serioze financiare, si dhe planin e kthimit të shumës së dhënë;*
- b) *të mandatojë Ministrinë e Financave për të negociuar ristrukturimin e borxheve dhe të detyrimeve të papaguara;*

- c) *të shpallë njësinë e vetëqeverisjes vendore në mbikëqyrje financiare dhe të autorizojë Ministrinë e Financave si mbikëqyrës financiar të saj, duke respektuar rigorozisht këto kushte:*
- i) *njësia e vetëqeverisjes vendore nuk mund të marrë asnjë vendim që mund të çojë në shtimin e detyrimeve të saj financiare;*
 - ii) *njësia e vetëqeverisjes vendore nuk mund të vendosë shërbime të reja publike, të themelojë sipërmarrje publike apo çdo institucion tjetër;*
 - iii) *njësia e vetëqeverisjes vendore nuk mund të shlyejë asnjë detyrim financiar, të krijuar para shpalljes së rastit të vështirësisë financiare, përveç detyrimeve të përcaktuara shprehimisht në planin e rehabilitimit financiar.”*

10.Numri i Punonjësve të NjQV

Gjatë vitit 2022, sipas sistemit informatik financiar të Qeverisë (SIFQ), numri total i punonjësve faktikë për 61 njësitë e qeverisjes vendore rezultoi 36,663 punonjës. Krahasuar me vitin 2021, evidentohet një rritje me 1859 punonjës më shumë. 35 nga 61 bashki të marra në analizë, kanë shtuar numrin e punonjësve krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ku spikasin veçanërisht bashkia Shkodër (+427 punonjës), bashkia Tiranë (+389 punonjës), bashkia Kamëz (+190 punonjës) dhe bashkia Memaliaj (+132 punonjës). Nga ana tjetër, vërehen bashki që kanë një trend në zbritje të numrit të punonjësve, ku veçohen bashkia Vorë (-33 punonjës), bashkia Roskovec (-13 punonjës) dhe bashkia Mallakastër (-10 punonjës).



Grafiku 17. Ndryshimi i nr të punonjësve

Programi i Institutit dhe Shërbimet

Instituti i Bashkive të Shqipërisë realizon qëllimet e veta nëpërmjet këtyre aktiviteteve:

TRAJNIME:

- **Në fushën e legjislacionit**

- Njohje dhe interpretim i ligjeve dhe akteve ligjore të ndryshme të funksionimit të qeverise vendore.
- Njohje dhe interpretim i legjislacionit të shërbimit civil dhe të Kodit të Punës.
- Njohje dhe analiza krahasuese me legjislacionin e vendeve të ndryshme nga ku mund të përfitohen eksperiencia të mira.
- Njohja me mënyra të hartimit të një ligji.
- Njohja me teknikat e hartimit të akteve ligjore që nxjerrin vetë organet e qeverisjes vendore.

- **Në fushën e decentralizimit dhe të integritit evropian**

- Njohje me Kartën Europiane të Autonomisë Lokale
- Programet vijuese dhe të rejtat lidhur me vazhdimësinë e proceseve të reformës të decentralizimit.

- **Në fushën e reformave administrative**

- Njohje me programet e reformave në administratën publike dhe atë në nivelet e qeverisë vendore.
- Trajnime lidhur me normat logjike për përpilimin dhe hartimin e misioneve dhe vizioneve për njësitë e vetëqeverisjes vendore.
- Trajnime lidhur me kryerjen e analizave të administrimit publik ,trajtimi i analizës SWOT.

- Menaxhim i personelit dhe teknikat përzgjedhëse dhe kualifikuese.
- Vlerësim dhe klasifikim dhe përshkrimi i punëve .
- Sistemi i kontrollit të brendshëm
- Karta e qytetarit etj.
- **Në fushën e menaxhimit të përgjithshëm**
 - Përdorimi i tokës, pyjeve dhe kullotave.
 - Menaxhim i pronave të qeverisë vendore
 - Zhvillim i qëndrueshëm mjedisor
 - Menaxhim i burimeve njerëzore
 - Menaxhim i burimeve natyrore
 - Ndërtimi i një kulture të qëndrueshme në administratën lokale
- **Në fushën e politikbërjes dhe zhvillimit**
 - Drejtim politik
 - Drejtim administrativ
 - Zhvillim komuniteti
 - Komunikim me publikun dhe aktorë të tjerë lokal
 - Njohje dhe gjetja e mekanizmave dhe instrumentave të nevojshme për zhvillim të qëndrueshëm lokal
 - Vendimmarrje etj.
- **Në fushën e menaxhimit dhe kontrollit financiar**
 - Metodatat dhe sistemet e financimit
 - Menaxhim i buxhetit dhe të ardhurave
 - Hartim dhe menaxhim i projekteve
- **Në fushën e shërbimeve publike vendore**
 - Menaxhim i mbetjeve, i aseteve dhe kapitalit natyror në bashki
 - Çështje mjedisore, kontrolli i territorit dhe mbrojtja e tij
 - Zhvillimi bujqësor dhe turizmi rural
 - Zhvillimi ekonomik vendor dhe partneriteti me biznesin

- Shërbimet sociale të integruara dhe zyrat me një ndalesë
- Shërbimi i furnizimit me ujë dhe kanalizime
- Menaxhimi dhe mbrojtja nga rreziqet natyrore, etj.

STUDIME

- Klasifikim i problematikave në organet e qeverisjes vendore duke ju referuar faktorëve prezent në njësitë përkatëse, sidomos me ecurinë e reformës së decentralizimit.
- Studime dhe analiza krahasuese me sistemet e qeverisjes vendore në vendet te tjera, nga të cilat mundet të marrim praktikat më të mira.
- Studime lidhur me strukturat dhe organigramën e administratës lokale.
- Studime të dokumentave evropiane që i përkasin qeverisjes vendore.

ASISTENCË TEKNIKE

- në fushën e hartimit të projekteve.
- në fushën e binjakëzimeve.
- në fushën e menaxhimit të personelit dhe ristrukturimit të administratës.
- në implementimin e Axshendës Lokale 2030 dhe OZhQ.
- në planifikimin e investimeve,
- konsulencë në hartim rregulloresh.
- konsulencë në hartimin planeve strategjike të zhvillimit
- konsulencë per arshivimin e dokumentacionit
- konsulencë në hartimin profilit të bashkisë
- konsulencë për hartimin e profilit dhe organizimit strukturor të bashkive dhe njërive administrative.

INSTITUTI PËR BASHKITË E SHQIPËRISË
'për qytete të qëndrueshme'

Në përbërje të INSTITUTIT janë angazhuar specialistë dhe ekspertë me eksperiencë në strukturat e pushtetit lokal, administratës publike dhe shoqërisë civile.

Aneks 1: Detyrimet e Prapambetura të NjQV për periudhën 2020-2022 (në milionë lekë)

Nr.	Emërtimi	2020	2021	2022	Diferenca 2022 - 2021	Diferenca (ne %) 2022 - 2021
1	Bashkia Tiranë	761.8	653.2	1179.7	526.5	80.6%
2	Bashkia Kavajë	727.8	820.0	837.5	17.5	2.1%
3	Bashkia Vorë	702.6	515.6	412.9	-102.7	-19.9%
4	Bashkia Pogradec	338.7	320.6	278.4	-42.2	-13.2%
5	Bashkia Lezhë	308.4	278.6	95.0	-183.6	-65.9%
6	Bashkia Roskovec	302.2	175.9	65.1	-110.8	-63.0%
7	Bashkia Kamëz	265.4	261.2	210.8	-50.4	-19.3%
8	Bashkia Vlorë	256.6	115.2	113.5	-1.7	-1.5%
9	Bashkia Malësi e Madhe	223.9	322.8	69.0	-253.8	-78.6%
10	Bashkia Durrës	185.4	306.8	110.5	-196.3	-64.0%
11	Bashkia Dibër	174.6	140.6	392.5	251.9	179.2%
12	Bashkia Kuçovë	156.3	124.2	173.0	48.8	39.3%
13	Bashkia Elbasan	153.9	107.8	49.2	-58.6	-54.4%
14	Bashkia Berat	143.3	170.6	36.0	-134.6	-78.9%
15	Bashkia Lushnjë	134.8	98.5	35.8	-62.7	-63.7%
16	Bashkia Divjakë	130.2	103.8	37.6	-66.2	-63.7%
17	Bashkia Belsh	128.2	214.5	45.2	-169.4	-78.9%
18	Bashkia Dimal	124.1	133.5	156.0	22.5	16.8%
19	Bashkia Tropojë	119.3	77.2	71.0	-6.2	-8.1%
20	Bashkia Rrogozhinë	113.2	93.9	77.9	-16.0	-17.0%
21	Bashkia Cërrik	111.8	181.3	157.8	-23.5	-13.0%

RAPORT MBI QEVERISJEN VENDORE NË SHQIPËRI 2022

Nr.	Emërtimi	2020	2021	2022	Diferenca 2022 - 2021	Diferenca (ne %) 2022 - 2021
22	Bashkia Poliçan	102.7	78.6	40.6	-38.0	-48.4%
23	Bashkia Selenicë	99.0	54.5	61.8	7.2	13.3%
24	Bashkia Fier	88.5	193.1	113.7	-79.4	-41.1%
25	Bashkia Himarë	75.2	27.7	26.6	-1.1	-4.0%
26	Bashkia Kukës	72.7	108.0	83.8	-24.3	-22.4%
27	Bashkia Mirditë	66.9	49.7	31.6	-18.1	-36.4%
28	Bashkia Pukë	59.3	47.4	38.5	-8.9	-18.8%
29	Bashkia Klos	58.4	41.6	23.9	-17.7	-42.6%
30	Bashkia Tepelenë	58.1	39.2	26.2	-13.0	-33.2%
31	Bashkia Devoll	57.3	51.6	115.6	63.9	123.9%
32	Bashkia Sarandë	57.2	30.9	7.8-23.1	-74.9%	
33	Bashkia Librazhd	55.8	19.8	10.0	-9.8	-49.6%
34	Bashkia Korçë	53.3	11.7	0.3	-11.4	-97.5%
35	Bashkia Delvinë	51.8	51.4	49.0	-2.4	-4.7%
36	Bashkia Finiq	50.1	52.7	34.7	-18.0	-34.1%
37	Bashkia Krujë	50.0	36.9	28.5	-8.4	-22.8%
38	Bashkia Peqin	32.3	63.9	103.4	39.5	61.9%
39	Bashkia Skrapar	29.6	26.7	15.6	-11.2	-41.8%
40	Bashkia Bulqizë	28.3	8.0	7.7-0.2	-3.0%	
41	Bashkia Has	27.5	16.9	8.8	-8.1	-48.0%
42	Bashkia Memaliaj	24.3	17.4	13.4	-4.0	-22.9%
43	Bashkia Mat	19.9	20.6	20.5	-0.1	-0.6%
44	Bashkia Gramsh	19.7	32.5	12.6	-19.9	-61.1%

RAPORT MBI QEVERISJEN VENDORE NË SHQIPËRI 2022

Nr.	Emërtimi	2020	2021	2022	Diferenca 2022 - 2021	Diferenca (ne %) 2022 - 2021
45	Bashkia Prrenjas	16.2	12.7	1.6-11.2	-87.6%	
46	Bashkia Kurbin	15.8	19.9	65.8	45.9	231.2%
47	Bashkia Maliq	14.1	62.1	10.6	-51.5	-82.9%
48	Bashkia Konispol	13.6	35.3	14.3	-21.1	-59.7%
49	Bashkia Kolonjë	12.2	5.3	0.3	-5.0	-94.3%
50	Bashkia Mallakastër	10.6	10.6	10.4	-0.2	-1.5%
51	Bashkia Shijak	9.6	7.1	33.2	26.1	366.6%
52	Bashkia Libohovë	8.0	5.7	28.9	23.2	407.0%
53	Bashkia Fushë-Arrëz	8.0	5.9	4.8	-1.1	-18.8%
54	Bashkia Vau-Dejës	7.8	9.6	3.3	-6.3	-65.2%
55	Bashkia Përmet	6.3	6.2	45.5	39.3	637.9%
56	Bashkia Gjirokastrë	3.3	0.0	9.2	9.2	0.0%
57	Bashkia Shkodër	3.2	3.4	0.6	-2.8	-83.1%
58	Bashkia Pustec	1.4	1.2	146.7	145.6	12352.0%
59	Bashkia Dropull	0.0	2.7	9.0	6.2	228.7%
60	Bashkia Këlcyrë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0%
61	Bashkia Patos	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0%
TOTALI		6,930.6	6,484.5	5,862.9	-621.6	-9.6%

Aneks 2: Transferta e pakushtëzuar për bashkitë për vitin 2022

Në mijë lekë

Nr.	Bashkitë	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme 2022	Konviktet e arsimit parauniversitar	Arsimi parashkollor			Arsimi parauniversitar	Mbrojtja nga zjarri	Mbrojtja sociale	Administrimi i pyjeve	Rrugët	Ujta dhe kullimi	Kubet shumësportëshe "Partizani dhe "Studenti"	Totali Në mijë lekë
				Ndarë me formë për personelin mësimor	Për stafin mbështetës									
1	Belsh	124,983	0	27,491	1,551	1,284	13,866	0	931	8,483	10,563	0	189,153	
2	Berat	308,280	27,665	109,155	40,336	14,546	32,725	23,984	5,893	5,228	15,699	0	583,510	
3	Bulqizë	273,559	0	54,979	10,104	0	20,003	0	15,004	30,955	14,155	0	418,759	
4	Cërrik	148,346	4,644	46,651	5,566	5,882	16,041	0	2,327	1,948	16,927	0	248,332	
5	Delvinë	67,724	0	20,909	5,042	1,863	13,997	0	2,655	3,654	10,563	0	126,407	
6	Devoll	199,230	0	55,734	3,549	2,595	14,238	0	4,702	11,254	12,107	0	303,409	
7	Dibër	425,819	24,326	128,198	29,747	9,921	26,436	0	8,606	15,173	14,927	0	683,153	
8	Divjakë	220,870	0	55,459	1,513	1,358	13,276	0	936	8,403	31,499	0	333,314	
9	Dropull	83,191	0	2,795	524	1,180	13,866	0	4,647	5,440	6,576	0	118,218	
10	Durrës	877,905	22,977	197,350	50,924	19,539	51,851	0	3,341	25,934	47,422	0	1,297,244	
11	Elbasan	711,855	28,749	228,936	58,487	34,484	36,089	21,333	12,681	18,878	15,699	0	1,167,190	

RAPORT MBI QEVERISJEN VENDORE NË SHQIPËRI 2022

12	Fier	618,189	21,500	174,483	41,848	11,439	35,439	27,040	4,211	9,205	61,953	0	1,005,308
13	Finiq	125,140	0	9,058	1,537	0	16,276		3,718	3,032	16,470	0	175,232
14	Fushë Arrëz	81,069	0	23,703	10,084	4,803	21,041	0	20,298	14,508	2,984	0	178,490
15	Gjirokastrë	219,985	18,262	82,347	25,210	6,287	30,619	0	7,335	8,278	10,168	0	408,491
16	Gramsh	223,688	6,524	71,310	9,075	3,861	17,837	0	16,101	20,988	10,563	0	379,947
17	Has	148,628	6,800	34,074	3,549	3,060	15,753	0	9,279	1,721	10,563	0	233,428
18	Himarrë	124,998	0	15,110	1,028	645	16,399	0	8,224	4,821	10,563	0	181,787
19	Kamëz	526,497	0	188,930	31,700	10,442	49,677	0	572	0	3,756	0	811,574
20	Kavajë	226,373	12,856	72,864	17,143	6,845	17,721	0	936	6,052	20,834	0	381,624
21	Këlcyrë	62,850	0	8,408	1,513	2,964	14,041	0	3,313	8,278	10,563	0	111,931
22	Klos	144,730	0	27,152	5,546	1,877	13,866	0	7,866	10,867	2,984	0	214,888
23	Kolonjë	124,983	9,820	33,376	5,546	4,254	16,657	0	16,261	9,639	18,843	0	239,379
24	Konispol	62,899	0	11,190	1,551	0	13,866	0	1,810	1,866	11,335	0	104,517
25	Korçë	462,077	22,114	147,076	43,865	19,592	31,163	0	15,805	7,067	47,566	0	796,325
26	Krujë	295,925	0	85,114	16,658	3,778	19,777	0	6,247	7,679	17,242	0	452,418
27	Kuçovë	168,659	0	61,519	18,655	7,243	15,195	2,650	1,535	2,174	14,155	0	291,785
28	Kukës	329,778	19,644	92,433	31,764	5,132	56,828	2,525	11,959	20,749	6,576	0	577,388
29	Kurbin	234,268	0	85,705	23,675	15,894	16,542	0	2,958	4,180	21,605	0	404,827

RAPORT MBI QEVERISJEN VENDORE NË SHQIPËRI 2022

30	Lezhë	340,463	9,399	101,851	27,731	18,397	39,055	0	8,242	5,589	23,920	0	574,646
31	Libohovë	42,729	0	6,174	1,551	1,191	13,866	0	2,841	6,859	2,993	0	78,203
32	Librazhd	287,603	0	69,972	10,104	3,283	14,837	0	9,179	26,012	14,155	0	435,146
33	Lushnje	417,311	9,348	141,465	31,280	11,838	15,606	0	1,817	7,916	49,109	0	685,689
34	Malë e Madhe	304,520	4,253	54,168	3,025	5,479	25,100	0	17,694	13,945	13,878	0	442,062
35	Maliq	309,640	0	80,163	4,072	10,732	13,866	0	6,038	9,368	41,659	0	475,539
36	Mallakastër	164,087	0	60,256	15,630	7,044	15,545	0	2,996	7,735	14,155	0	287,449
37	Mat	195,016	12,738	56,822	18,655	7,680	17,003	0	9,467	27,154	12,563	0	357,098
38	Memaliaj	107,766	0	32,753	5,042	7,762	14,066	0	3,432	4,730	2,993	0	178,543
39	Mirditë	207,162	22,116	49,138	17,134	7,880	19,827	0	16,000	20,224	16,155	0	375,635
40	Patos	134,575	0	43,404	12,605	3,717	19,045	0	1,144	1,949	15,741	0	232,180
41	Peqin	134,477	0	39,942	5,062	4,058	14,540	0	1,511	4,647	10,563	0	214,800
42	Përmet	122,060	6,634	22,510	5,042	4,947	17,412	0	6,079	7,332	10,563	0	202,580
43	Pogradec	371,147	0	134,639	7,583	9,930	19,645	0	18,041	22,001	11,335	0	594,321
44	Polican	102,099	0	27,559	6,935	5,334	15,407	0	4,181	3,684	3,793	0	168,992
45	Përrenjas	179,902	0	44,491	5,081	3,780	16,341	0	8,068	19,824	12,563	0	290,050
46	Pukë	115,050	13,822	31,735	12,605	7,680	19,495	0	13,048	6,945	2,984	0	223,363
47	Pustec	36,255	0	6,075	325	0	18,876	0	918	335	5,984	0	68,767

RAPORT MBI QEVERISJEN VENDORE NË SHQIPËRI 2022

48	Roskovec	115,119	0	30,719	2,541	2,437	13,866	0	1,144	4,257	7,348	0	177,430
49	Rrogozhinë	148,325	0	32,372	6,070	2,477	13,276	0	1,486	0	10,563	0	214,569
50	Sarandë	134,873	18,567	45,797	13,109	3,796	18,999	0	2,716	0	6,576	0	244,433
51	Selenicë	176,714	0	28,218	4,558	10,022	15,866	0	4,767	2,955	16,555	0	259,654
52	Shijak	141,939	0	38,496	6,555	3,131	18,276	0	936	51	6,576	0	215,961
53	Shkodër	665,861	58,505	126,163	53,445	25,911	41,893	36,651	11,866	20,135	29,451	0	1,069,880
54	Skrapar	127,428	11,198	36,029	11,216	9,793	19,537		9,530	13,592	15,563	0	253,886
55	Tepelenë	86,777	6,800	33,566	8,067	3,690	14,412		5,302	6,622	2,988	0	168,225
56	Tiranë	2,523,451	90,860	620,016	261,174	91,645	119,614		10,353	21,270	22,506	32,000	3,792,888
57	Tropojë	212,844	0	44,046	11,596	3,738	17,452		15,578	9,369	3,484	0	318,108
58	Dimal	142,830	0	48,006	524	1,689	13,997		918	4,049	19,686	0	231,698
59	Vau i Dejës	230,732	8,813	40,685	1,047	2,457	13,276	19,958	6,944	6,134	12,878	0	342,925
60	Vlorë	565,117	26,042	209,457	66,049	33,264	43,796		6,279	2,920	41,600	0	994,525
61	Vorë	125,574	0	44,044	2,541	5,273	13,276		932	525	10,563	0	202,729
Totali		16,591,944	524,975	4,532,238	1,135,242	520,822	1,378,149	134,140	409,597	564,582	966,310	32,000	26,790,000
Totali në euro		135.5 mln	4.2 mln	37 mln	9.2 mln	4.2 mln	11.2 mln	1 mln	3.3 mln	4.6 mln	7.8 mln	261 mijë	218 mln

Kursi i këmbimi 1 euro = 122.41 lekë

Referenca

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (përcaktime në nenet 108-113) <https://www.parlament.al/Kuvendi/Kushtetuta>
2. Karta Evropiane e Vetqeverisjes Vendore të Këshillit të Evropës <https://rm.coe.int/european-charter-of-local-self-government-alb-a6/16808d7b36>
3. Ligji 115/2014 “Për Ndarjen Administrative Territoriale” https://aam.org.al/wp-content/uploads/2018/11/Ligj_115-2014_31.07.2014.pdf
4. Ligji 139/2015 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Vetqeverisjes Vendore” <https://www.dap.gov.al/legjislacioni/per-administraten-publike/40-ligj-nr-1392015-date-17-12-2015-per-veteqeverisjen-vendore>
5. EU. *Commission Staff Working Document. Albania 2022 Report*. COM (2021) 644 final. Brussel, 12.10.2022
6. Enti Rregullator i Ujit. *Raporti Vjetor 2022*. Tiranë, Mars2023; erru.gov.al
7. Ministria e Financave. *Raporti i Buxhetit Vendor 9 mujori 2022*. Tiranë, 2023; financa.gov.al
8. OECD. *Impact of COVID-19 in Albania. Multi-dimensional Review of the Western Balkans : Assessing Opportunities and Constraints* | OECD iLibrary (oecd-ilibrary.org)
9. Qirjo.M., Shaplo.O., *Raporti I monitorimit të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane 2021-2022*. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Tiranë 2023
10. World Bank. *Disaster Risk Finance Diganostic Albania*. December 2020.
11. World Bank. *The impact of COVID-19 related budget re-allocations*. September 2021
12. Shërbimi Social. *Raporti Vjetor 2022*. Mars 2023; shssh.gov.al

